



# USAID

NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA



## Femrat dhe biznesi: Barazia gjinore në biznes

Analizë e hulumtimit të opinionit publik

## **Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE)**

# **Barazia gjinore në biznes: Analizë e hulumtimit të opinionit publik**

Maj 2014

Kontrata Nr.. AID-167-C-13-00001

Ky publikim është përgatitur për rishikim nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Publikimi është përgatitur nga programi i USAID për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), i implementuar nga Checchi and Company Consulting Inc.

Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial  
Adresa: Rr. Sejdi Kryeziu. nr. H9, 10,000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
[www.checchiconsulting.com](http://www.checchiconsulting.com)

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk pasqyrojnë me doemos pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar ose Qeverisë Amerikane.

## SHKURTESAT

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
SBZHV	Strategjia për bashkëpunim për zhvillimin e vendit
CLE	Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial
PKBGJ	Programi i Kosovës për barazi gjinore
IMF	Institucion mikrofinanciar
RAE	Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët
SEAD	Programi sistemet për përmbarimin e marrëveshjeve dhe vendimeve
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

## Përmbajtja

SHKURTESAT .....	3
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	5
2. SFONDI .....	7
3. METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET .....	7
4. GJETJET.....	8
4.1. Gjendja demografike e të anketuarve .....	8
4.2. Mjedisi ekonomik.....	8
4.2.1. Konteksti.....	8
4.2.2. Perceptimet që kanë dalë nga anketa .....	12
4.3. Përvoja me grupet e fokusit.....	24
4.4. Mjedisi ligjor .....	25
4.4.1. Konteksti.....	25
4.4.2. Perceptimet që kanë dalë nga anketa .....	26
4.4.3. Përvoja me grupet e fokusit.....	30
5. PËRFUNDIMET .....	32
6. REKOMANDIME .....	32
SHTOJCA 1: REFERENCAT .....	36
SHTOJCA 2: HOLLËSI PËR METODOLOGJINË .....	38
SHTOJCA 3: ANKETA .....	39

# 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet analizën e hulumtimit cilësor të kryer nga programi i USAID-it për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), për të kuptuar dhe regjistruar perceptimet rreth hendeqeve ekzistuese gjinore dhe rolit të femrave në biznes<sup>1</sup> në Kosovë. Një anketë opinionesh me 1288 qytetarë të Kosovës të zgjedhur në mënyrë të rastësishme, e plotësuar me diskutime nëpër grupe fokusi me femra që janë pronare biznesi, qoftë të martuara, të divorcuara, të veja, ose beqare, formon bazën e hulumtimit.

Qëllim kryesor i anketës ka qenë të përcaktohet nëse perceptimet rreth pengesave përballë femrave për t'iu qasur mundësive në mjedisin ekonomik (si për shembull, punësimi, pozita vendimmarrëse, qasja në financa etj.) dhe mjedisin ligjor (si për shembull, trajtimi në gjykata, kërkimi i të drejtave pronësore dhe trashëgimore etj) janë në përputhje me informatat që janë dokumentuar dhe raportuar deri tani, e që (ndoshta) pasqyrojnë realitetin në lidhje me hendeqet dhe rolet gjinore në biznes në Kosovë.

Në përgjithësi, gati gjysma e më tepër e të anketuarve besojnë që qasja në mundësi është gati-gati e njëjlojtë si për meshkujt ashtu edhe për femrat (përveç qasjes në mundësitë për biznes dhe mbështetjes së mundësive për biznes), dhe që të dyja gjinitë do të ishin njëjloj efektivë si udhëheqës. Mirëpo, këto perceptime nuk manifestohen në realitet. Ky konstatim vlen sidomos kur bëhet fjalë për qasjen në financa ku, ndonëse katër të pestat e të anketuarve perceptojnë qasje të barabartë në financa për të dy gjinitë, më pak se një e treta e femrave kanë marrë hua. Të anketuarit janë përgjithësisht të vetëdijshëm për pengesat ndaj pjesëmarrjes së femrave në biznes, ose kërkimit të së drejtës së tyre trashëgimore, dhe i identifikojnë në përputhje me faktet tanimë të dëshmuara rreth pabarazisë gjinore në këto fusha. Veç kësaj, analiza ka vërejtur edhe stereotipa të femrave (për shembull, se femrat nuk kanë prirje për biznes), të ngulitur njësoj si te meshkujt ashtu edhe femrat.

Gjetjet e hulumtimit mund të përmbliidhen sa vijon:

## Mjedisi i të bërit biznes

- Më se gjysma e të anketuarve (57.91%) besojnë se të dy gjinitë kanë **qasje të barabartë në mundësitë për punësim**.
- Gati gjysma e të anketuarve (49.56%) mendojnë që si meshkujt ashtu edhe femrat mund të jenë njëjloj efektivë si **udhëheqës biznesi**, dhe shumica syresh (60%) mendojnë se të dyja gjinitë do të ishin **udhëheqës politikë** njëjloj të mirë. Por, këto dy pyetje kanë gjetur gjithashtu se gati një e katërta e femrave të anketuara besojnë që meshkujt janë udhëheqës më të mirë në biznes dhe politikë, e që, mbas gjase, është rezultat i mjedisëve tradicionale patriarkale në të cilat femrave u mësohet se punët e shtëpisë u shkojnë më shumë për shtati dhe se kontributi i tyre nuk ka vlerë në biznes dhe politikë.
- Si pengesë kyçe karshi pjesëmarrjes së femrave në biznes raportohet të jenë **përgjegjësitë ndaj familjes** (52.03%).
- Nga një e treta deri gjysma e të anketuarve besojnë se shkak i mundshëm për pjesëmarrjen e pamjaftueshme të femrave në biznes mund të jetë stereotipi i ngulitur gjinor se “femrat nuk kanë prirje për biznes.”
- Shumica e femrave të anketuara (68.52%) mendojnë që **mungesa e ndihmës shtetërore** është për t'iu fajësuar për numrin e pamjaftueshëm të femrave në pozita të larta nëpër kompani.
- Në përputhje me përqindjen shumë të ulët të pjesëmarrjes së femrave në ekonominë e Kosovës, pak më pak se gjysma e të anketuarve besojnë se të dyja gjinitë **kanë qasje të barabartë në mundësitë për**

---

<sup>1</sup> Për qëllime të këtij raporti, sistemi i tregtisë shqyrtohet në dritën e dy mjedisëve në kuadër të së cilëve funksionon kryesisht programi CLE – mjedisin ekonomik dhe atë ligjor.

**biznes (43.81%) dhe mbështetjen e nevojshme për biznes (43.06%),** duke e përmendur **tradi tën** si pengesë kryesore.

- Për dallim nga femrat (4.42%), më tepër se dyfishi i meshkujve e anketuara (10.28%) kanë raportuar se janë pronarë biznesi. Krahasuar me meshkujt, pronaret femra të bizneseve kanë raportuar shkallë më të ulët angazhimi në veprimtaritë ditore, dhe më se 40% të tyre ua kanë lënë në duar vendimarrjen meshkujve të vet.
- Shumica e bizneseve të të anketuarve ishin financuar me **fonde familjare (10.53%) dhe personale (8.70%),** siç është edhe rasti me femrat ndërmarrëse të cilat kanë marrë pjesë në grupet e fokusit.
- Përgjithësisht, problem më i shpeshtë dhe më i madh për pronarët e bizneseve (si meshkujt ashtu edhe femrat) janë **normat e larta të interesit (45.24%) dhe mungesa e kapitalit investues (41.22%).**
- Në përputhje me drojën e përgjithshme nga huatë, **më pak se një e treta (32,55%)** e të anketuarve kanë marrë kredi nga ndonjë bankë apo institucion financiar tjetër, me një dallim domethënës mes meshkujve (38.69%) dhe femrave (27,81%). Megjithatë, **rreth katër të pestat (80,45%) e të anketuarve mendojnë se të dy gjinitë kanë shanse të barabarta për të marrë hua.**
- **Mungesa e bashkëpunimit dhe kontakteve** midis femrave ndërmarrëse është identifikuar si pengesë e madhe për zhvillimin e mëtutjeshëm të bizneseve në pronësi të femrave nga ana e pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit.

## Mjedisi ligjor

- Më shumë se një e treta e femrave të anketuara (39.83%), dhe gati një e treta e meshkujve të anketuar (30,04%), mendojnë që **në Kosovë meshkujt trajtohen më mirë se femrat.**
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (54.56%) raportojnë se femrat në familjet e tyre nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre ligjore të trashëgimisë. Më shumë se dy të tretat (69,34%) e atyre që deklarojnë se femrat nuk i ushtrojnë të drejtat e tyre trashëgimore, kanë përmendur traditat familjare si arsye kryesore për këtë lloj sjelljeje. Më se një e treta e të anketuarve (35.02%) raporton se ka besim të plotë në sistemin gjyqësor. Të anketuarit të cilët u besojnë gjykatave deri në një masë, ose nuk u besojnë fare, si arsye kryesore të mosbesimit të tyre kanë përmendur mes tjerash **korupsionin, padrejtësinë dhe mosefikasitetin.** Vetëm një e katërta deri një e treta e të anketuarve janë të mendimit se çështjet ligjore nuk po përmbahen në mënyrë efektive. Pjesëmarrëset e grupit të fokusit po ashtu nuk kanë besim në efikasitetin dhe paanshmërinë e gjykatave, dhe parapëlqejnë që problemet lidhur me biznesin t'i zgjidhin jashtë gjykatave.
- Më shumë se gjysma e të anketuarve (53,65%) **mendojnë që femrat dhe meshkujt trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjykatat,** prej të cilëve këtë mendim e ndajnë më shumë meshkuj (57,89%) se femra (50.29%).
- Të anketuarit kanë shfaqur mirëbesim më të madh ndaj gjykatave kur bëhet fjalë për adresimin e mosmarrëveshjeve personale, se sa për ato të natyrës së biznesit. Gati dy **të tretat e femrave të anketuara (62,44%) nuk dinë si të veprojnë** përballë mosmarrëveshjeve afariste.
- Tri të katërtat e të anketuarve (75,43%) **nuk kanë dëgjuar kurrë për ndërmjetësimin apo arbitrazhin si rrugë për zgjidhje të mosmarrëveshjeve.** Në mesin e atyre që e dinë se çfarë është arbitrazhi, 71,49% nuk e dinë nëse ka të njëjtën peshë sikurse vendimet gjyqësore apo jo.
- Gjithsej 43.54% e të anketuarve mendojnë që **janë të informuar për të drejtat që i gëzojnë si qytetarë të Kosovës** deri në një farë mase, deri 51,96% mendojnë që janë plotësisht të informuar.

## 2. SFONDI

Që prej fillimit të tij në maj të vitit 2013, programi i USAID-it për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) bazohet në përparimin e arritur nga ana e programit të USAID-it për sistemet për përmbarimin e marrëveshjeve dhe vendimeve (SEAD), dhe programet tjera të USAID-it dhe donatorëve tjerë. Aktivitetet e programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) përfshijnë përpjekjet për të zvogëluar ngarkesën me lëndë në sistemin gjyqësor të Kosovës, përmbarimin efektiv të vendimeve të gjykatave dhe zbatimin e kontratave, aftësimin e gjyqtarëve, avokatëve e përmbaruesve, zgjerimin e mekanizmave të ndërmjetësimit, përmirësimet në legjislacionin për biznes, duke përfshirë këtu legjislacionin mbi falimentimin, si dhe detyra tjera në lidhje me komunitetin e biznesit. Programi përqendrohet në përmirësimin e mundësisë së qytetarëve, bizneseve dhe sistemit gjyqësor për zbatim në kohë dhe të drejtë të kontratave, detyrimeve dhe vendimeve gjyqësore në dobi të qytetarëve dhe bizneseve.

Një prej parimeve kyçe udhëheqëse të programit për përmbarim dhe legjislacion komercial është promovimi i barazisë gjinore dhe të siguruarit që si meshkujt ashtu edhe femrat të përfitojnë nga aktivitetet e programit. Kjo është në pajtim edhe me politikën e USAID-it për barazi gjinore dhe fuqizimin e gruas, si dhe me Strategjinë e USAID-it në Kosovë për bashkëpunim për zhvillimin e vendit (SBZHV) 2014-2018 që përsëritë domosdoshmërinë dhe rëndësinë e integritit gjinor në portofolin e projekteve të USAID-it në Kosovë. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave të besueshme e të kategorizuara sipas gjinisë në sektorin ligjor dhe atë të biznesit, që të dytë sektorë të rëndësishëm për aktivitetet e programit për përmbarim dhe legjislacion komercial, programi ka kontraktuar një anketë të opinionit publik rreth mënyrës se si nocionet e barazisë gjinore dhe rolit të femrave si udhëheqëse, ndërmarrëse dhe qytetare të thjeshta vështrohen brendapërbrenda sferave ekonomike dhe ligjore. Hulumtimi shtesë ka përfshirë diskutimet në grupe fokusi me femra që janë pronare biznesi dhe janë qoftë të martuara, të veja apo të divorcuara, për t'i kuptuar më mirë problemet dhe sfidat me të cilat përballlet kjo kohortë femrash. Analiza e këtij hulumtimi jo vetëm që do t'i ndihmojë programit për përmbarim dhe legjislacion komercial për t'i matur qëndrimet aktuale publike përkitazi me barazinë gjinore në biznes dhe qasje në drejtësi, por edhe në planifikimin e aktiviteteve të tij të ardhme.

## 3. METODOLOGJIA DHE KUFIZIMET

Metodologjia për këtë raport ka përfshirë shqyrtimin në zyrë të dokumenteve përkatëse lidhur me pjesëmarrjen e femrave në mjediset ekonomike dhe ligjore në Kosovë dhe ndërkombëtarisht (Shtojca 1), si dhe analizën e pyetjeve të pyetësorit (Shtojca 2) dhe transkriptave të grupeve të fokusit.

Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) ka bërë hulumtime cilësore dhe kuantitative me qëllim përcaktimin e perceptimeve rreth femrave në biznes. Hulumtimi sasior ka ngërthyer anketimin e 1288 meshkujve dhe femrave që përfaqësonin grupe të ndryshme etnike nga anekënd Kosova, të cilët janë pyetur për perceptimet e tyre rreth barazisë gjinore në fusha të caktuara, që përfshijnë, por nuk kufizohen, në udhëheqjen, pronësinë e biznesit, qasjen në drejtësi, si dhe në hendeqet e perceptuara gjinore. Hulumtimi cilësor është kryer përmes intervistave me tri grupe fokusi të femrave që janë pronare biznesesh, të cilat kanë qenë të martuara, të veja, të divorcuara ose të pamartuara, të përbëra nga gjithsej 40 pjesëmarrëse. Derisa anketa pa pasur si qëllim të përcaktojë perceptimet, grupet e fokusit i kanë plotësuar gjetjet e anketës me të dhëna anektodike të bazuara në përvojat personale të pjesëmarrëseve. Përshkrimi i hollësishëm i metodologjive të anketës dhe grupeve të fokusit është paraqitur në Shtojcën 3.

Në këtë raport analizohen vetëm ato pyetje të pyetësorit që kanë qenë më të ndërlidhura me femrat dhe biznesin në kuptim të fushëveprimit të programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE). Për të përcaktuar nëse meshkujt dhe femrat u janë përgjigjur pyetjeve ndryshe nga njëri-tjetri, janë bërë testet Pearson  $\chi^2$ . Si rregull, përveç nëse përmendet ndryshe, mund të supozohet që dallimet e gjetura për sa i përket mënyrës se si meshkujt dhe femrat u janë përgjigjur pyetjeve kanë arritur nivele konvencionale të domethënies statistikore (p-value <



.05). Dy kufizime të mundshme të instrumentit të anketës përfshijnë: 1) problemet me vlefshmërinë e matjes, që mund të shfaqen për shkak të pasaktësive në pyetjet e parashtruara (për shembull, për pronësinë e biznesit pyetet në tri pyetje të ndryshme të anketës, ndërkaq përgjigjet e dhëna janë të ndryshme për që të tria pyetjet), dhe 2) animi kah përgjigjet që janë më të pranueshme në kontekstin social (për shembull, individë të cilët përgjigjen se e përkrahin barazinë gjinore, sepse këtë pritet ta bëjnë).

Derisa shqiptarët përbëjnë 92% të popullsisë së gjithëmbarshme të Kosovës, përfaqësimi i tyre në mostrën e anketës është pak më i ulët se 65%. Për ta adresuar shpeshësinë e shtuar të zgjedhjes së mostrave të pakicave etnike, është bërë edhe një analizë tjetër. Ajo i ka ndarë përgjigjet e të anketuarve shqiptarë nga ato të grupeve tjera etnike, për të vlerësuar nëse përgjigjet e tyre ndryshojnë në mënyrë domethënëse nga mostra e gjithëmbarshme. Nga 59 pyetjet e anketës të analizuar në këtë raport (të paraqitura në analizën e mëposhtme), në vetëm 8 sish ka shpërputhje statistikore midis rezultateve të mostrës shqiptare dhe mostrës së gjithëmbarshme. Prandaj, duket se mbipërfaqësimi i pakicave etnike nuk ka çuar në ndonjë ndryshim domethënës të rezultateve të anketës.

## 4. GJETJET

Gjetjet përkritazi me hendeqet gjinore në mjediset ekonomike dhe ligjore, që janë nxjerrë nga anketa dhe grupet e fokusit, paraprihen nga përmbledhje kontekstuale të secilit mjedis.

### 4.1. Gjendja demografike e të anketuarve

Karakteristikat e përzgjedhura të 1288 personave të cilët kanë marrë pjesë në anketën e CLE-së përfshijnë:

- **Gjininë:** 55.72% ishin femra dhe 44.28% meshkuj;
- **Përkatësinë etnike:** 64.30% ishin shqiptarë; 17.81% serbë; 3.36% boshnjakë; 0.78% goranë; 5.23% turq; 2.66% romë; 3.20% ashkalinj; dhe 2.66% egjiptianë;
- **Gjendjen martesore:** 67.98% ishin të martuar; 25.22% ishin beqarë; 0.79% ishin të divorcuar; 3.32% ishin të ve; dhe 2.69% raportuan se bashkëjetojnë me partnerin e tyre; dhe
- **Shkollimin:** shumica e të anketuarve deklaruan nivel të shkollimit si në vijim: 1) shkollë fillore (26.26%); 2) shkollë e mesme/teknike/profesionale (27.69%) dhe; 3) shkollim universitar/pasuniversitar (27.06%).

### 4.2. Mjedisi ekonomik

#### 4.2.1. Konteksti

Raporti i Bankës Botërore “Të bërit biznes” i vitit 2014 identifikon Kosovën si një prej 10 shteteve më të mira reformuese në vitin 2013, me reforma të realizuara në 3 nga 10 tregues të *të bërit biznes* (hapja e biznesit, marrja e lejeve të ndërtimit dhe regjistrimi i pronës),<sup>2</sup> duke e përmirësuar efektivisht rangimin e Kosovës nga vendi i 96-të në 2013 në vendin e 86-të në 2014. Sidoqoftë, Kosova vazhdon të jetë e pllakosur në ekonomi të dobët, papunësi e varfëri të madhe. Nga këndvështrimi gjinor, gjendja ekonomike e tanishme shpalosë hendeqe të mëdha gjinore në një varg faktorësh që kontribuojnë në rritje ekonomike: punësimi, udhëheqja, pronësia e biznesit dhe qasja në financa.

#### *Punësimi*

*Studimi i fuqisë punëtore të Kosovës në 2012* ka nxjerrë disa statistika që flasin mjaft për hendekun gjinor në punësim, duke përfshirë:<sup>3</sup>

<sup>2</sup> <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo>

<sup>3</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore në 2012 në Kosovë, Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës, f. 9.



- Më pak se një në pesë (17.8%) femra në moshë pune janë aktive në tregun e punës, krahasuar me më shumë se gjysmën e meshkujve (55.4%) në moshë pune;
- Në mesin e fuqisë punëtore, papunësia është shumë më e madhe të femrat sesa meshkujt (40.0% krahasuar me 28.1%); dhe
- Shkalla e punësimit të femrave në moshë pune është vetëm 10.7% krahasuar me 39.9% për meshkujt.

Mosprania e femrave në tregun e punës është rrjedhojë e kushteve joadekuate të punës (për shembull, nuk ka orar fleksibil të punës) dhe faktit se punëdhënësit shfaqin rezerva kur bëhet fjalë për punësimin e femrave të reja, të cilat janë në moshën për t'u bërë nënë, duke u nisur nga pushimi i gjatë i lehonisë i paraparë me Ligjin e punës të Kosovës, barra e kostos së të cilit sipas ligj bie më së shumti mbi punëdhënësit. Veç kësaj, qasja e femrave në punësim pengohet edhe nga shpalljet diskriminuese për vende pune që mund të përcaktojnë se “femrat të cilat aplikojnë të mos jenë mbi moshën 30 vjeçare.”<sup>4</sup>

Ndonëse Ligji i punës parasheh që pushimi i lehonisë të zgjasë një vit (gjashtë muajt e parë paguhen nga punëdhënësi, tre muajt në vijim paguhen nga qeveria dhe tre muajt të tjerë janë pa pagesë), të dhënat anekdotike sugjerojnë që jo rrallëherë ndodh që femrat të pushohen nga puna pasi të kenë mbetur shtatzëna, nga që punëdhënësi nuk dëshiron t’jua paguajë rrogën gjatë pushimit të lehonisë dhe, njëherazi, të paguajë rrogë edhe për zëvendësimin e përkohshëm.<sup>5</sup> Ose, ato punësohen vetëm për kohë të shkurtër, gjë që e lejon punëdhënësin që t’i largojë nga puna fare lehtë dhe pa ndërlikime të mundshme ligjore. Aktualisht po bëhen përpjekje për ta ndryshuar dispozitën për pushimin e lehonisë në Ligjin e punës, që mund të rezultojnë ose në shkurtimin e pushimit të lehonisë në nëntë muaj ose ndryshimin e strukturës së pagesës nga palët përgjegjëse.

### *Udhëheqja*

Mungesa e dukshme e femrave në pozitat udhëheqëse në biznes dhe politikë është pengesë kyçe për përparimin e Kosovës. Në përgjithësi, ndër arsyet që mund të kontribuojnë në numrin e vogël të udhëheqëseve femra në sektorin privat përfshihen "përqindja e ulët e femrave të punësuar, barra e madhe e përgjegjësisë shtëpiake, mungesa e mekanizmave të mirëfilltë për vlerësim të performancës dhe femradim të punonjësve në sektorin privat, paragjykimin shoqëror ndaj femrave në pozita të larta, praktika që kanë të ngjarë të jenë diskriminuese, si dhe mungesa e roleve model.”<sup>6</sup>

Femrat kosovare përbëjnë vetëm 0.3% të menaxherëve të lartë nëpër kompanitë private, përqindje kjo ndër më të ulëtat në vendet e Evropës dhe Azisë Qendrore,<sup>7</sup> ku femrat përbëjnë mesatarisht 20% të menaxherëve të kompanive.<sup>8</sup> Një studim i Odës Ekonomike të Kosovës në vitin 2012<sup>9</sup> i femrave në pozita vendimmarrëse në sektorët publik dhe privat ka gjetur se nga 71 kompani private (kryesisht ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM)) që përfaqësonin katër sektorë (TIK, turizmi, bujqësia dhe financat), femrave u ishte besuar vetëm një mesatare prej 4.2% e pozitave vendimmarrëse.<sup>10</sup> Për më tepër, në tri ndërmarrje publike të rëndësishme, Postën dhe Telekomin e Kosovës (PTK), Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Aeroportin e Prishtinës,

<sup>4</sup> Riinvest (2013), Të paguash apo të mos paguash: Joformaliteti nga perspektiva e biznesit në Kosovë, Prishtinë: Instituti Riinvest, f. 27.

<sup>5</sup> Checchi Consulting (2013), Analizë gjinore e Programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), Uashington: USAID, f. 5.

<sup>6</sup> Banka Botërore, Njësia për zvogëlim të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore (2012), Kosova: Hendeqet gjinore në mundësitë arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, Uashington: Banka Botërore, f. 26.

<sup>7</sup> Evropa Lindore dhe Qendrore, ish-Bashkimi Sovjetik dhe Turqia.

<sup>8</sup> Banka Botërore, Njësia për zvogëlim të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore (2012), Kosova: Hendeqet gjinore në mundësitë arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, Uashington: Banka Botërore, f. 26.

<sup>9</sup> Studimi nuk specifikon se çfarë nënkuptohet me pozitë “vendimmarrëse”.

<sup>10</sup> Oda Ekonomike e Kosovës dhe GIZ (2012), Pushteti aktual në vendimmarrje i grave në Kosovë, qëndrimet dhe perspektivat në ekonomi, Prishtinë, f. 16.

përçindja e femrave në pozita vendimmarrëse ishte përkatësisht 20%, 11% dhe 9%.<sup>11</sup> Kjo mungesë jo vetëm që iu ofron femrave “më pak përvojë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e bizneseve krahasuar me meshkujt, mirëpo, gjithashtu, vështirëson gjasat e femrave që të hapin biznese.”<sup>12</sup>

Veç kësaj, një hulumtim i kohëve të fundit i qeverisjes korporative në ndërmarrjet publike në Kosovë përmend numra të ulët të femrave që aplikojnë për t’u bërë anëtare të bordeve, dhe nënpërfaqësimin e tyre ua atribuon aspekteve historike e kulturore dhe kuotave të pjesëmarrjes në qeveri, si dhe parregullsive të mëdha në përzgjedhje, përfshirë ndikimet e mëdha politike.”<sup>13</sup>

Femrat nuk qëndrojnë më mirë as në politikë. Ndonëse Kosova ka për presidente një femër, dhe 33% e ulëseve në parlament u takojnë femrave (pjesërisht, për shkak të kuotës gjinore), efektshmëria e femrave deputeteve është vënë shpesh në pikëpyetje për faktin se, në të shumtën e rasteve, ato nuk dalin jashtë vijave ideologjike të partisë politike të cilën e përfaqësojnë, edhe pse ideologjitë në fjalë shpesh nuk përfillin barazinë gjinore. Gjithashtu, vetëm 4 nga 22 ministri të linjës drejtohen nga femrat, dhe vetëm një komunë udhëhiqet nga një femër. Në nivelin komunal vetëm 20 femra mbajnë postin e drejtoreshës, përkundër faktit që ekzistojnë mbi 320 drejtori në të 38 komunat.<sup>14</sup> Përfaqësimi i ulët i femrave në nivel komunal është adresuar së fundmi nga Kreu i Misionit të OSBE-së në Kosovë, i cili ka thënë që: “Ky numër është tregues i qartë se institucionet e Kosovës duhet të punojnë më shumë për të arritur barazi gjinore në radhët e tyre, duke i çuar më tej arritjet e shumta në normëzimin gjinor në vitet e fundit në Kosovë.”<sup>15</sup> Numri i ulët i femrave në pozita vendimmarrëse në zonat rurale mund t’i atribuohet faktit që “roli i femrave nëpër fshatra është sendërtuar tërësisht rreth familjes dhe punëve të shtëpisë, dhe ato nuk inkurajohen e mbështeten nga familjet për t’u përfshirë në vendimmarrje.”<sup>16</sup>

#### *Pronësia e biznesit*

Qeveria e Kosovës ka miratuar disa instrumente që mëtojnë promovimin e ndërmarrësisë dhe zhvillimin e NVM-ve. Programi i Kosovës për barazi gjinore (PKBGJ) në kuadër të Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe Plani i veprimit të Kosovës për fuqizimin ekonomik të femrave (2011-2013),<sup>17</sup> vendosin konturat e aktiviteteve të dizajnuara për të rritur pjesëmarrjen e femrave në ekonomi, duke përfshirë këtu edhe atë të femrave ndërmarrëse. Gjithashtu, Agjencia për Përkrahjen e NVM-ve (Mistria e Tregtisë dhe Industrisë), në strategjinë e vet për NVM-të (2012-2016), zotohet për të përmirësuar pozitën e femrave ndërmarrëse duke pranuar se mundësia e një mjedisi të favorshëm për krijimin dhe rritjen e ndërmarrjeve të tyre duhet të mbështetet me krijimin e politikave dhe të dhënave për pjesëmarrjen e femrave në ndërmarrësi, trajnime, përmirësim të qasjes në financa, krijimin e një rrjeti të punës dhe të praktikave të mira.<sup>18</sup> Në nivel të shoqërisë civile, Platforma Kombëtare e Femrave Sipërmarrëse në Republikën e Kosovës mëton promovojë femrat ndërmarrëse në Kosovë përmes partneriteteve publike dhe private.

Të dhënat e “Femrat, biznesi dhe ligji 2014” të Bankës Botërore për vitin 2013, që vlerëson **dallimet përballë ligjit** midis meshkujve dhe femrave në këto kategori: qasjen në institucione, shfrytëzimin e pronës, gjetjen e vendit të punës, ofrimin e lehtësirave për punë, historikun e mirë të huamarrjes, shkuarjen në gjykatë, si dhe mbrojtjen e femrave nga dhuna, ka gjetur se 10 nga 143 vendet që kanë qenë pjesë e studimit, përfshirë Kosovën,

<sup>11</sup> *Po aty*, f. 11.

<sup>12</sup> UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor të Kosovës 2012, Prishtinë: UNDP, f. 73.

<sup>13</sup> Riinvest dhe CIPE (2012), Qeverisja korporative në ndërmarrjet publike në Kosovë: Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes së fondeve publike në Kosovë, Prishtinë: Instituti Riinvest, f. 28.

<sup>14</sup> <http://europeandcis.undp.org/blog/2013/10/23/kosovo-assembly-pushes-for-womens-human-rights/>

<sup>15</sup> <https://www.osce.org/kosovo/116210>

<sup>16</sup> ABGJ (2014), Plani i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 “Femrat, paqja dhe siguria” 2013-2015, Prishtinë: ABGJ, f. 15.

<sup>17</sup> Plan veprimi për qëllimet programatike të fuqizimit ekonomik që janë përcaktuar në PKBGJ.

<sup>18</sup> Agjencia e Kosovës për Mbështetjen e NVM-ve (2011), Strategjia e zhvillimit të NVM-ve për Kosovën 2012-2016, me vizionin 20/20, Prishtinë: Qeveria e Kosovës, f. 30.

nuk bënin asnjë dallim gjinor në aspektin juridik.<sup>19</sup> Në përgjithësi, sa më e madhe të jetë barazia gjinore aq më i madh është numri i bizneseve në pronësi të femrave.<sup>20</sup> Por, ky konstatim duket se nuk qëndron në rastin e Kosovës. Që nga viti 2012, Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka mbledhur të dhëna rreth pronësisë së bizneseve që janë të klasifikuara sipas gjinisë, dhe raporton një përqindje prej 11% të bizneseve në pronësi të femrave.<sup>21</sup> Kjo përqindje është shumë e ulët krahasuar me mesataren rajonale prej 36%.<sup>22</sup> Pothuajse gjithë bizneset në pronësi të femrave (99%) janë mikro-ndërmarrje,<sup>23</sup> që do të thotë se veprojnë me fitim më të ulët, më me pak punëtorë dhe nivel më të ulët të kapitalizimit.<sup>24</sup>

Në pozitë veçanërisht të pafavorshme ndodhen femrat ndërmarrëse në zonat rurale. Një studim i bërë në vitin 2006 ka gjetur se shumica syresh "bëjnë biznes nga shtëpitë e tyre, më pak se 5 për qind udhëtojnë jashtë fshatit për të shkuar në punë, 77 për qind ua lënë në dorë gjithë vendimet e rëndësishme për biznesin anëtarëve meshkuj të familjes, dhe vetëm 13 për qind kanë deklaruar që jetojnë kryesisht nga të ardhurat e tyre personale."<sup>25</sup> Lënia e vendimmarrjes në duart e bashkëshortit, bijve ose vëllezërve nuk është diçka e pazakontë për femrat ndërmarrëse kosovare. Në një anketë me 1,450 femra të cilat janë pronare biznesi, 25% të atyre që janë bashkëpronare në biznes kanë raportuar se nuk marrin vendime për biznesin e tyre dhe se shumë prej tyre vendimmarrjen ua kanë lënë në dorë bashkëshortëve (50%) dhe vëllezërve (20%).<sup>26</sup>

### *Qasja në financa*

Qasja në financa përmendet shpesh si një prej pengesave kryesore përballë ndërmarrjeve në pronësi të femrave. Vlerësohet që në tërë botën "deri në 70% e NVM-ve në pronësi të femrave në sektorin formal në vendet në zhvillim nuk shërbehen ose apo shërbehen pak - një hendek financiar prej 285 miliardë dollarësh."<sup>27</sup> Në Kosovë, vetëm 3 % të kredive të bankave komerciale u shkojnë femrave.<sup>28</sup> Përveç kësaj, sektori i institucioneve mikrofinanciare (IMF), që përdoret shpesh ndërkombëtarisht si mjet për sigurim të huave për femrat, ka shënuar tkurrje në Kosovë "për shkak të konkurrencës së rritur nga bankat, regjimit rregullator të paqartë, dhe paaftësisë së shumë IMF-ve për të krijuar një model biznesi që do t'ju përgjigjej nevojave të tregut"<sup>29</sup> deri diku rreth 6 % të gjithë tregut të huadhënies, me shumë mesatare huash të dhëna rreth 1,800 euro.<sup>30</sup> Kur bëhet fjalë për mundësinë e huadhënies nga ana e qeverisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është aktualisht në fazën e krijimit të një skeme huash për mikro- biznese dhe NVM, e që bazohet në një studim fizibiliteti të kryer kohëve të fundit. Kriteret e marrjes së huasë do të jenë favorizuese ndaj femrave, duke u dhënë atyre 5-10 pikë shtesë për aplikim për hua. Sidoqoftë, ende nuk ka fond të veçantë të dedikuar për bizneset në pronësi të femrave.<sup>31</sup>

Mosdisponueshmëria e të dhënave për modelet e huamarrjes nga NVM-të kosovare, që janë të kategorizuara sipas gjinisë, e bën të vështirë që të bëhen konstatime në lidhje me NVM-të në pronësi të femrave. Sidoqoftë, në përgjithësi, NVM-të ngurrojnë të marrin hua nga bankat. Një analizë e IMF-ve në 2013 ka gjetur se vetëm rreth 32% e firmave në Kosovë kanë huazuar nga bankat, përqindje kjo që nuk e arrin as gjysmën e mesatares së

<sup>19</sup> Të dhënat për Kosovën janë në dispozicion në: <http://wbl.worldbank.org/data/exploreconomies/kosovo/2013>

<sup>20</sup> Ana Stupnytska, Kethrin Kosh, Ejmi Mekbith, Sandra Lauson dhe Kejthi Katsui (2014), Të thurësh lëvdata të merituar: Si mund t'i japë shtysë rritjes globale zvogëlimi i hendekut kreditor për NVM-të në pronësi të grave, Goldman Sachs, f.11.

<sup>21</sup> Letërkëmbim mes CLE dhe MTI, 20 mars 2014.

<sup>22</sup> Banka Botërore, Njësia për ulje të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore (2012), Kosova: Hendeqet gjinore në mundësitë arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, Uashington: Banka Botërore, f. 23.

<sup>23</sup> UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor të Kosovës 2012, Prishtinë: UNDP, f. 71.

<sup>24</sup> USAID-i në Kosovë 2014-2018: Strategjia për bashkëpunim për zhvillimin e vendit, Prishtinë: USAID-i në Kosovë, f. 10.

<sup>25</sup> UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor të Kosovës 2012, Prishtinë: UNDP, f. 75.

<sup>26</sup> Kethrin Kozarelli (2012), Vlerësim gjinor i vendit për USAID-in në Kosovë: Versioni për audiencë të jashtme, Uashington: USAID, f. 34.

<sup>27</sup> Ana Stupnytska, Kethrin Kosh, Ejmi Mekbith, Sandra Lauson dhe Kejthi Katsui (2014), Të thurësh lëvdata të merituar: Si mund t'i japë shtysë rritjes globale zvogëlimi i hendekut kreditor për NVM-të në pronësi të grave, Goldman Sachs, f.19.

<sup>28</sup> BERZH (2013), Strategjia për Kosovën, f. 51.

<sup>29</sup> Weidemann Associates (2012), Vlerësim i performancës afatmesme të projektit të USAID-it në Kosovë për garancitë për portofolin e huave (LPG) me bankën Raiffeisen sh.a.: Raport përfundimtar, Uashington: USAID, f. 10.

<sup>30</sup> Po aty, p. 10.

<sup>31</sup> Letërkëmbim mes CLE dhe MTI, 20 mars 2014.

Ballkanit (65%).<sup>32</sup> Sipas një anketimi të Institutit Riinvest me 600 NVM në Kosovë në 2011, 74% e NVM-ve janë financuar me të hyra dhe fonde personale, 12% nga bankat, dhe 10% nga familja dhe miqtë.<sup>33</sup> Arsyet kryesore pse NVM-të nuk aplikojnë për huamarrje përfshijnë normat e larta të interesit, të mos pasurit e nevojës për hua, besimin se nuk do të jenë në gjendje të marrin hua nga banka, si dhe kriteret e paarrtshme për kolateralin.<sup>34</sup> Sipas të dhënave të Bankës Qendrore, normat e interesit për kredi afariste janë rreth 15% , e për kreditë konsumatore rreth 13%.<sup>35</sup>

Kur bëhet fjalë për kolateralin, “bankat komerciale kërkojnë që çdo kredi mbi 10,000 euro të garantohet me kolateral, qoftë tokë apo ndërtesa, madje, madje edhe për kredi më të vogla zakonisht kërkohet njëfarëlloj kolaterali... Shpesh, kreditë e NVM-ve garantohen me paluajtshmëri, qoftë depo apo zyra të kompanisë, qoftë me shtëpinë e pronarit. Andaj, financimi i hipotekave është komponent i rëndësishëm i financave të NVM-ve.”<sup>36</sup> Meqë nuk është e pazakontë që femrat të heqin dorë nga të drejtat e tyre trashëgimore dhe, si rrjedhojë, mundësia për të pasur kolateral, afro 92% të aseteve të kolateralit, të nevojshme për të nisur biznese të reja, janë të regjistruara në emër të meshkujve.<sup>37</sup>

Shpesh, kuadri ligjor (Ligji për familjen, Ligji për trashëgiminë, Ligji për noterinë, Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore), që parasheh të drejta të barabarta pronësore dhe trashëgimore për meshkujt dhe femrat, mbizotërohet nga praktikat tradicionale, që diktojnë se e bija duhet të heqë dorë nga pjesa e saj e trashëgimisë, sidomos nëse është e martuar. Kjo mbështetet ligjërisht edhe nga Ligji për trashëgiminë, që parasheh të drejtën e heqjes dorë nga trashëgimia. Në një anketë rreth së drejtas së trashëgimisë pronësore të femrave në Kosovë të kryer në vitin 2011, më shumë se 61% e të anketuarave kanë deklaruar që, edhe në qoftë se nëse do ta kërkonin të drejtën e tyre trashëgimore, do të pengoheshin nga familja e ngushtë apo e gjera.<sup>38</sup> Kështu, madje edhe ato pak femra të cilat mund të jenë të vetëdijshme për të drejtën e tyre në trashëgimi mund të vendosin për të hequr dorë nga ajo, duke qenë se 27.3% e të anketuarave në radhë të parë i vënë marrëdhëniet e vëllezërit dhe prindërit e tyre, e pastaj pronën.<sup>39</sup> Si rrjedhojë e kësollj praktikave, vetëm 8% e femrave kosovare janë pronare tokash<sup>40</sup> (vetëm 2% të femrave të anketuara kanë qenë titullarë pronash).<sup>41</sup>

#### 4.2.2. Perceptimet që kanë dalë nga anketa

##### *Punësimi*

Kur janë pyetur për perceptimet e tyre rreth barazisë së meshkujve dhe femrave të së njëjtës moshë dhe nivel shkollimi në qasjen në mundësitë për punësim, pakëz më shumë se gjysma e të anketuarve kanë qenë të mendimit se të dy gjinitë kanë mundësi të barabarta për t’u punësuar (57,91%) (shih Figurën 1) ose për t’u pushuar nga puna (55,94%) (shih Figurën 2).

<sup>32</sup> Deloitte Consulting sh.p.k (2013), Sistemi i pikëreferimit në sektorin financiar: Përmbledhje për Kosovën, USAID, f. 6.

<sup>33</sup> Instituti Riinvest (2012), Sektori bankar: Lehtësues apo barrierë, Prishtinë: KFOS, f. 40.

<sup>34</sup> *Po aty*, p.40.

<sup>35</sup> Deloitte Consulting sh.p.k (2013), Sistemi i pikëreferimit në sektorin financiar: Përmbledhje për Kosovën, USAID, f. 6.

<sup>36</sup> Instituti Riinvest (2012), Sektori bankar: Lehtësues apo barrierë, Prishtinë: KFOS, f. 42.

<sup>37</sup> BERZH (2013), Strategjia për Kosovën, f. 51.

<sup>38</sup> Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2011), E drejta e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë, Prishtinë, f.42.

<sup>39</sup> *Po aty*, f. 38.

<sup>40</sup> USAID-i në Kosovë, Profili i të drejtave pronësore dhe qeverisjes së burimeve, f. 7.

<sup>41</sup> Analiza gjinore e Programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), Prishtinë, 2013, USAID-i në Kosovë, f.13.




Figura 1 Nëse burri dhe gruaja kanë të njëjtën moshë dhe nivel shkollimi, kush ka më shumë të ngjarë që të punësohet, burri apo gruaja? (të ndara sipas gjinisë) (P.B9)




Figura 2 Nëse burri dhe gruaja kanë të njëjtën moshë dhe nivel shkollimi, kush ka më shumë të ngjarë që të pushohet nga puna, burri apo gruaja? (të ndara sipas gjinisë) (P.B10)

Mirëpo, siç u përmend më herët, femrat në tregun e punës përballen me diskriminime që nuk vlejnë për meshkujt - sfida zakonisht të lidhura me moshën e tyre, dhe janë jashtëzakonisht të prirura për t'u punësuar për kohë të shkurtër, apo për t'u pushuar nga puna, vetëm dhe vetëm sepse janë në moshën për t'u bërë nënë apo shtatzëna. Ç'është edhe më interesante, kur të anketuarit të cilët kishin deklaruar që femrat kishin më gjumë gjasa për të fituar një vend të punës u pyetën që të jepnin më shumë hollësi, ca thanë se arsyeja ishte pamja e femrave. Qëndrimet si ky vetëm sa i rrënjosin edhe më tej stereotipat ekzistues, ku te gruaja vlerësohet pamja e jashtme, e jo arritjet e saj.

Në kuptim të pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës (përveç të qenurit pronarë biznesi), në përputhje me shkallën e lartë të papunësisë dhe të ekonomisë joformale në Kosovë, shumica dërrmuese e të anketuarve të të dyja gjinive (86.20%) kanë deklaruar që nuk janë të angazhuar në asnjë veprimtari që sjellë të ardhura (shin Figurën 3).<sup>42</sup>

<sup>42</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.




Figura 3 A jeni i/e angazhuar në ndonjë veprimtari që ju sjellë të ardhura (jo doemos biznes i regjistruar)? (të ndara sipas gjinisë)(P.B.16.2)

### Udhëheqja

Përkundër përqindjes mjaft të ulët të femrave në pozita udhëheqëse në Kosovë, pothuajse gjysma (49.56%) e të anketuarve janë të mendimit se si meshkujt ashtu edhe femrat mund të jenë udhëheqës njëjloj efektivë në biznes (shih Figurën 4). Derisa kjo është inkurajuese, stereotipat gjinor tradicional janë të dukshëm në përgjigjet e 41.58% të meshkujve dhe 26.46% të femrave, që besojnë se meshkujt janë udhëheqës më të mirë.




Figura 4 Sipas mendimit tuaj, cilët janë udhëheqës më të mirë biznesi, meshkujt apo femrat? (të ndara sipas gjinisë) (Q.B4)

Pikëpamjet rreth shkathtësisë së femrave si udhëheqëse biznesi janë hetuar edhe më në hollësi, duke i pyetur të anketuarit nëse do të ndiheshin rehat po qe se do ta kishin si shefe një grua. Më se dy të tretat e të anketuarve (70.06%) raportuan se nuk do të kishin asgjë kundër kësaj (shih Figurën 5), duke dëshmuar besim të fuqishëm në barazinë gjinore në këtë mënyrë.<sup>43</sup>

<sup>43</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.




Figura 5 A do të ndiheshit rehat po qe se do të punonit për një shefe apo menaxhere femër? (të ndara sipas gjinisë) (B7)

Përkundër prirjes së përgjithshme për të punuar nën mbikëqyrje të femrave, shumica (68.82%) e të anketuarve<sup>44</sup> janë të mendimit se në biznes ka më shumë meshkuj se femra (shih figurën 6), ndërsa më tepër se gjysma e të anketuarve (54.81%)<sup>45</sup> besojnë se meshkujt kanë më shumë gjasë të emërohen në pozita drejtuese nëpër kompani (shih figurën 7). Kështu, duket se njerëzit e kanë kuptojnë realitetin e hendekut gjinor në botën e biznesit.




Figura 6 Sipas mendimit tuaj, a ka në biznes më shumë meshkuj apo femra? (të ndara sipas gjinisë) (P.B13)




Figura 7 Në shoqërinë tuaj, kush ka më shumë të ngjarë të emërohet në një pozitë të lartë në një kompani? (të ndara sipas gjinisë) (P.B14)

Kur janë pyetur për arsyet pse femrat nuk kanë pozita të larta nëpër kompani (shih Tabelën 1), shumica e të anketuarve (66.89%) kanë qenë të mendimit se kjo ndodh për shkak se sektori i biznesit dominohet nga (ndonëse, mund të argumentohet që kjo është më shumë rrjedhojë se shkaktar). Mirëpo, shumica (68.52%) e femrave të anketuara mendojnë se arsyeja kryesore e numrit të pamjaftueshëm të femrave që mbajnë pozita të larta drejtuese nëpër kompani është **mungesa e ndihmës nga shteti**. Gjersa nuk është dhënë asnjë shembull

<sup>44</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.

<sup>45</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënëse në kuptimin statistikor.



specifik se për çfarë ndihme shtetërore është fjala, duket qartazi se femrat kosovare mendojnë që qeveria ka rol të rëndësishëm në fuqizimin ekonomik të tyre.

	<b>Meshkuj (%)</b>	<b>Femra (%)</b>	<b>Gjithsej (%)</b>
U mungojnë tiparet/shkollimi/shkathësitë	28.31	22.29	24.94
Nuk mund të jenë po aq të përkushtuara sa meshkujt ndaj punës me pagë	44.34	41.14	42.55
Për shkak të zgjedhjeve të tyre personale	58.81	56.22	57.36
Për shkak të trysnisë së ushtruar nga familja	54.83	59.36	57.36
Trysnia e ushtruar nga kolegët në rrethin e tyre të ngushtë profesional	34.45	41.68	38.49
Mungesa e ndihmës nga shteti	57.20	68.52	63.55
Spektori i biznesit dominohet nga meshkujt.	65.49	67.98	66.89
Traditat kosovare nuk i inkurajojnë sa duhet	54.65	62.32	58.93
Nuk ka kopshte të mjaftueshme për fëmijë	53.90	52.34	53.03

Tabela 1 Arsyet e numrit të pamjaftueshëm të femrave që mbajnë pozita të larta (të ndara sipas gjinisë)

Gjithashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve (52.03%) janë të mendimit se përgjegjësitë ndaj familjes janë arsyeja më e madhe për pjesëmarrjen e pamjaftueshme të femrave në sferën afariste (shih Tabelën 2). Si meshkujt ashtu edhe femrat pajtohen përkitazi me përgjegjësitë familjare, mirëpo, sipas femrave të anketuara, arsye tjetër në radhë të dytë për nga rëndësia është mungesa e kapitalit (44.83%), derisa meshkujt mendojnë që është mungesa e përvojës të femrat (41.42%). Mjaft zhgënjyese është gjetja se më shumë se një e treta e popullsisë, gjegjësisht 40.92% e meshkujve dhe 41.30% e femrave, besojnë se arsyeja kryesore për pjesëmarrjen e pakët të femrave në biznes është sepse “femrat nuk kanë prirje për të bërë biznes.” Ky stereotip negativ është i dëmshëm për barazinë gjinore jo vetëm sepse përjetëson mite rreth punës që mund ta bëjë dikush mbi bazën e përkatësisë gjinore, por, sepse këtë e besojnë më se 40% të vetë femrave.

		<b>Meshkuj (%)</b>	<b>Femra (%)</b>	<b>Gjithsej (%)</b>
1. Femrat përballen me diskriminim në të gjitha fushat; as biznesi nuk përbën përjashtim	Arsye e rëndësishme	30.48	41.86	36.67
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	42.80	34.68	38.38
	Arsye e parëndësishme	16.91	13.66	15.14
	Nuk e di	9.81	9.81	9.81
2. Përgjegjësitë familjare ua pamundësojnë femrave që të kenë kohë për të bërë biznes	Arsye e rëndësishme	50.52	53.30	52.03
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	29.90	29.69	29.78
	Arsye e parëndësishme	11.96	10.59	11.22
	Nuk e di	7.63	6.42	6.97
3. Pak femra kanë përvojë në biznes	Arsye e rëndësishme	41.42	33.86	37.30
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	32.01	34.90	33.59
	Arsye e parëndësishme	16.32	20.42	18.55
	Nuk e di	10.25	10.82	10.56
4. Femrat nuk kanë kapital për të nisur një biznes	Arsye e rëndësishme	37.50	44.83	41.48
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	31.67	25.57	28.35
	Arsye e parëndësishme	20.63	18.56	19.51
	Nuk e di	10.21	11.03	10.66
5. Femrat nuk kanë prirje për biznes	Arsye e rëndësishme	40.92	41.30	41.13
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	28.81	28.30	28.53
	Arsye e parëndësishme	17.33	17.57	17.46
	Nuk e di	12.94	12.83	12.88
6. Femrat nuk kanë ambicie për biznes	Arsye e rëndësishme	21.25	18.45	19.73
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	31.46	24.08	27.45
	Arsye e parëndësishme	31.25	43.41	37.85
	Nuk e di	16.04	14.06	14.97
7. Femrat nuk kanë vetëbesim për të bërë biznes	Arsye e rëndësishme	24.12	21.79	22.86
	Arsye jo dhe aq e rëndësishme	34.72	29.70	32.00
	Arsye e parëndësishme	23.49	31.81	28.00
	Nuk e di	17.67	16.70	17.14

Tabela 2 Arsytet pse në biznes ka më shumë meshkuj se sa femra (të ndara sipas gjinisë)

Në fund, në kuptim të udhëheqjes politike, shumica e të anketuarve (60%) kanë thënë se të dyja gjinitë do të ishin njëjloj të mirë si udhëheqës politik (shih Figurën 8). Mirëpo, është dekurajuese që perceptimet e pothuajse një së tretës mbesin prapanike kur është fjala për barazinë gjinore në politikë, nga që 35.84% të meshkujve dhe 24.45% të femrave besojnë që meshkujt janë udhëheqës më të mirë politikë. Për fat të keq, perceptimet e tyre përkojnë me realitetin në Kosovë, duke ditur numrin e vogël të femrave të emëruara në pozita vendimmarrëse në politikë. Të anketuarit të cilët mendonin se meshkujt janë udhëheqës më të mirë kanë dhënë përgjigje më të hollësishme kur janë pyetur pse mendojnë asisoj. Në përgjithësi, ata i kanë përshkruar meshkujt si “më të mirë”, duke përdorur stereotipa të rrënjësor fort sikurse “më të saktë”, “të aftë” dhe “më të mençur”, por njëherësh edhe karakteristika që mund ta pasqyrojnë vërtetë realitetin, sikurse “më të shkolluar” dhe “më të informuar”.




Figura 8 Sipas mendimit tuaj, cilët janë udhëheqës më të mirë politik, meshkujt apo femrat ? (të ndara sipas gjinisë) (B6)

### Pronësia e biznesit

Kur bëhet fjalë për pronësinë e bizneseve, krahasuar me femrat (4.42%), përqindje më e lartë e meshkujve (10.28%) kanë raportuar se janë pronarë biznesesh (shih Figurën 9). Shkalla e raportuar e bizneseve në pronësi të femrave është më e ulët për më shumë se përgjysmë krahasuar me 11% të raportuar në nivel shteti.




Figura 9 A keni biznes tuajin privat? (të ndara sipas gjinisë) (B16)

Gjithashtu, 26% të të anketuarve<sup>46</sup> kanë raportuar që familja e tyre është pronare e një biznesi privat (shih Figurën 10).




Figura 10 A ka familja juaj biznes privat? (të ndara sipas gjinisë) (B17)

<sup>46</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.

Dallim tjetër gjinor i vërejtur është qasja e tyre ndaj punëve ditore. Derisa 61.45% e pronarëve meshkuj të bizneseve kanë deklaruar se angazhohen personalisht në punët ditore të biznesit, më pak se gjysma e pronareve femra të bizneseve (29.51%) janë menaxhere kryesore të biznesit të tyre. Në të vërtetë, në rastin e shumicës së pronareve femra të bizneseve (40.98%), janë bashkëshortët e tyre ata që merren me punët ditore të lidhura me biznesin, krahasuar me vetëm 15.66% të pronarëve meshkuj të bizneseve që kanë raportuar të njëjtën (shih Figurën 11). Kjo mund t’ju atribuohet përgjegjësi që kanë femrat në shtëpi dhe, për rrjedhojë, kohës së pamjaftueshme për t’u marrë vetëm me biznesin gjatë tërë kohës. Për më tepër, kjo gjetje përkon me hulumtimet tjera të përmendura më herët në raport lidhur me bizneset në pronësi të femrave dhe vendimmarrjen nga femrat.




Figura 11 Nëse jeni pronar i një biznesi privat, kush merret me punët ditore të lidhura me biznesin? (të ndara sipas gjinisë) (B16.1)

Përgjithësisht, problem më i madh dhe më i shpeshtë për pronarët e bizneseve janë normat e larta të interesit (45.24%) dhe mungesa e kapitalit investues (41.22%). Ndonëse këto gjetje (shih Tabelën 3) nuk kanë domethënie statistikore (d.m.th. të dhënat nuk mund të gjejnë ndonjë dallim statistiki të rëndësishëm për sa i përket mënyrës se si u janë përgjigjur pyetjeve meshkujt dhe femrat), ato përkojnë me gjetjet e hulumtimeve tjera për këtë temë, që shtjellohen tjetërkund në këtë raport.

		Meshkuj (%)	Femra (%)	Gjithsej (%)
Shkalla e tatimit	Problem i madh	36.49	37.93	37.12
	Përbën problem deri-diku	40.54	34.48	37.88
	Nuk përbën fare problem	22.97	27.59	25.00
Procesi i pagesave	Problem i madh	18.92	16.95	18.05
	Përbën problem deri-diku	54.05	42.37	48.87
	Nuk përbën fare problem	27.03	40.68	33.08
Sistemi ligjor	Problem i madh	30.56	18.97	25.38
	Përbën problem deri-diku	41.67	43.10	42.31
	Nuk përbën fare problem	27.78	37.93	32.31
Mungesa e kapitalit investues	Problem i madh	49.32	31.03	41.22
	Përbën problem deri-diku	30.14	44.83	36.64
	Nuk përbën fare problem	20.55	24.14	22.14
Normat e larta të interesit	Problem i madh	48.57	41.07	45.24
	Përbën problem deri-diku	27.14	30.36	28.57
	Nuk përbën fare problem	24.29	28.57	26.19
Punëtorë jo të shkathtë	Problem i madh	10.29	8.62	9.52
	Përbën problem deri-diku	29.41	31.03	30.16
	Nuk përbën fare problem	60.29	60.34	60.32
Korrupsioni	Problem i madh	31.34	21.43	26.83
	Përbën problem deri-diku	14.93	16.07	15.45
	Nuk përbën fare problem	53.73	62.50	57.72
Të tjera	Problem i madh	7.27	6.67	7.00
	Përbën problem deri-diku	12.73	28.89	20.00
	Nuk përbën fare problem	80.00	64.44	73.00

Tabela 3 Problemet me të cilat përballen pronarët e bizneseve (të ndara sipas gjinisë)

Në përputhje me përqindjen shumë më të ulët të femrave të cilat marrin pjesë në ekonominë e Kosovës, shumica e të anketuarve besojnë që qasja në mundësitë për biznes nuk është e barabartë për të dyja gjinitë, dhe kanë dhënë përgjigje se meshkujt kanë qasje më të mirë (37.75%), femrat kanë qasje më të mirë (2.23%) ose nuk e di (16.20%) (shih Figurën 12).<sup>47</sup>




Figura 12 A Kanë meshkujt dhe femrat qasje të barabartë në mundësitë për biznes? (të ndara sipas gjinisë) (B22)

<sup>47</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.

Në po të njëjtën mënyrë, shumica e të anketuarve<sup>48</sup> pranojnë qasjen e pabarabartë të të dy gjinive në përkrahjen për të hapur biznes të ri (shih Figurën 13).




Figura 13 A kanë meshkujt dhe femrat qasje të barabartë në përkrahjen për të nisur biznes të ri? (të ndara sipas gjinisë) (B23)

Arsyet sipas të anketuarve për këto dallime në qasje janë paraqitur më poshtë (shih Tabelën 4), me traditën të cekur si arsye kryesore për qasjen jo të barabartë në mundësitë për biznes (57.73%) dhe përkrahje të biznesit (66.21%). Gjetjet në Tabelën 4 nuk kanë domethënie statistikore (d.m.th. të dhënat nuk mund të gjejnë ndonjë dallim domethënës në kuptimin statistikor për sa i përket mënyrës se si u janë përgjigjur pyetjeve meshkujt dhe femrat).

	Qasja në mundësitë për biznes			Qasja në përkrahje të biznesit		
	Meshkuj (%)	Femra (%)	Gjithsej (%)	Meshkuj (%)	Femra (%)	Gjithsej (%)
Shkollimi	8.37	7.37	44	5.56	10.34	8.30
Tradita	57.37	58.01	57.73	65.74	66.55	66.21
Mungesa e njohurive ligjore	3.98	3.53	3.73	4.63	2.76	3.56
Mungesa e financave	7.57	9.62	8.70	14.81	12.41	13.44
Dallimet gjinore, d.m.th. amësia	18.33	17.31	17.76			
Mungesa e kujdesit ditor për fëmijë	1.99	3.21	2.66			
Mungesa e informatave				5.56	5.17	5.34
Të tjera	2.39	0.96	1.60	3.70	2.76	3.16

Tabela 4 Arsyet e qasjes jo të barabartë në mundësitë për biznes dhe përkrahje të biznesit (të ndara sipas gjinisë)

### Qasja në financa

Shumica e të anketuarve të cilët janë pronarë biznesesh, biznesin e tyre e kanë hapur me financim familjar apo personal (shih Tabelën 5). Ngurrimi i kosovarëve për të marrë hua nga bankat vërtetohet edhe një herë nga fakti se vetëm 3.13% e të anketuarve kanë huazuar nga bankat. Gjetjet në Tabelën 5 nuk kanë domethënie statistikore (d.m.th. të dhënat nuk mund të gjejnë ndonjë dallim domethënës në kuptimin statistikor për sa i përket mënyrës se si u janë përgjigjur pyetjeve meshkujt dhe femrat).

<sup>48</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.

	Meshkuj (%)	Femra (%)	Gjithsej (%)
Me kapital personal	10.86	7.02	8.70
Me kapitalin e familjes	13.11	8.50	10.53
Me hua bankare	3.37	2.93	3.13
Me hua nga një i afërm	1.50	0.88	1.15
Me donacion nga një organizatë ndërkombëtare	0.75	0.88	0.82

Tabela 5 Burimet financiare për nisjen e një biznesi të ri (të ndara sipas gjinisë)

Në përputhje me drojën e përgjithshme nga huatë, më pak se një e treta (32.55%) e të anketuarve kanë huazuar nga bankat apo institucion tjetër financiar, me një dallim të madh midis meshkujve (38.69%) dhe femrave (27.81%) (shih Figurën 14). Përqindja më e ulët e femrave që kanë marrë hua mund të jetë gjithashtu rrjedhojë e pengesave që paraqiten si rrjedhojë e mungesës së kolateralit, temë që është shtjelluar më herët në raport.




Figura 14 A keni marrë ndonjëherë hua nga ndonjë bankë apo institucion tjetër financiar? (të ndara sipas gjinisë) (B26)

Gjithashtu, 60.09% e femrave dhe 66.15% e meshkujve nuk e njohin asnjë grua që ka marrë kredi nga ndonjë IMF (shih Figurën 15).




Figura 15 A njihni femra që kanë marrë kredi nga ndonjë institucion financiar? (të ndara sipas gjinisë) (B.28)



Mirëpo, vlen të ceket që gjysma deri dy të tretat e të anketuarve<sup>49</sup> as nuk e dinë se çfarë është një IMF (shih Figurën 16). Ky dallim prej pothuajse 10 për qind midis nivelit të njohurisë së meshkujve (61.72%) dhe femrave (52.53%) është çështje që duhet shqyrtuar më tej në kontekst të hendeqeve gjinore sa u përket njohurive financiare në Kosovë.




Figura 16 A e dini se çfarë është një institucion mikrofinanciar? (të ndara sipas gjinisë) (B27)

Në fund, ndonëse shumica e femrave të anketuara nuk kanë marrë asnjëherë hua, dhe shumica e të anketuarve të të dyja gjinive nuk njohin asnjë grua e cila ka marrë hua, afro katër të pestat (80.45%)<sup>50</sup> mendojnë që të dyja gjinitë kanë gjasa të barabarta për huamarrje (shih Figurën 17). Kjo gjetje dëshmon që perceptimi i barazisë së madhe gjinore në qasjen në hua/financa, ndonëse në përputhje me kuadrin ligjor, nuk përkon me realitetin aktual në Kosovë. Kështu, mosdija e shumicës dërrmuese të të anketuarve (posaçërisht femrave) flet për rëndësinë dhe nevojën e rolit të shtuar të qeverisë në edukimin e qytetarëve rreth të gjitha aspekteve të realitetit ekonomik në Kosovë.




Figura 17 A mendoni që femrat mund të marrin kredi më lehtë se meshkujt, apo është më e vështirë për to? (të ndara sipas gjinisë) (B29)

<sup>49</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.

<sup>50</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.

### 4.3. Përvoja me grupet e fokusit

Siç u përmend më herët, diskutimet me grupet e fokusit kanë siguruar një këndvështrim shtesë ndaj çështjeve gjinore në biznes, dhe kanë qenë më tepër të bazuara në përvojat e pjesëmarrëseve në ndërmarrësi se sa në mendimet e tyre për tema të caktuara. Prurjet e përgjithshme nga diskutimet në grupe fokusi lidhur me mjedisin e të bërit biznes janë paraqitur më poshtë:

- **Përkrahja nga familja** është identifikuar si faktor kyç mbështetës nga ana e pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit. Derisa shumica e femrave kanë deklaruar se të qenit pronare e një biznesi nuk i ka liruar nga përgjegjësitë familjare, ndihma e familjes ua ka lehtësuar vazhdimin e punës.
- Gjithë pjesëmarrëset kanë shprehur **dëshirë të madhe për t'u marrë me biznes**, dhe kanë deklaruar që, po t'u jepej mundësia, do të nisnin edhe një biznes tjetër.
- Shumica e pjesëmarrëseve kanë thënë që **qasja në financa** është një prej pengesave kryesore për zhvillimin e biznesit të tyre, duke deklaruar që, ndonëse huamarrja nga bankat është gjë e domosdoshme për nisje apo zgjerim të biznesit, kushtet e huadhënies, d.m.th. **normat e larta të interesit** dhe fillimi i pagesës së huasë pak kohë pas marrjes së saj, janë të pafavorshme. Si rrjedhojë, shumica syresh nuk kanë mundur të nisin ndonjë biznes të ri apo ta zgjerojnë biznesin ekzistues.
- Shumica e femrave e kanë nisur biznesin e tyre me **financim personal apo me ndihmën e familjes**. Pak pjesëmarrëse kanë marrë femrante, ose kanë marrë hua nga IMF-të. Disa pjesëmarrëse kanë shprehur ngurrimin e tyre për të huazuar nga IMF-të, për shkak se normat e tyre të interesit janë më të larta se të bankave. Sipas një pjesëmarrëseje, *“nëse merr hua nga [organizata X], norma e tyre e interesit është aq e lartë sa që do ta shpenzosh krejt fitimin për ta shlyer huanë dhe, përveç kësaj, koha për kthimin e huasë është shumë e shkurtër, nuk shkon përtej tre viteve.”* Një pjesëmarrëse tjetër ka ndarë përvojën e marrjes së një huaje me normë të ulët interesi prej 3% “nga një organizatë nga Bangladeshi”, me ç' rast kredia u ishte dhënë një grupi femrash dhe ato kishin punuar së bashku për të ndarë mënjanë para për ta shlyer atë.
- Për t'i bërë kushtet e huadhënies më të favorshme, pjesëmarrëset do të dëshironin që bankat të ofrojnë më shumë lehtësira, siç janë **“grejs” periudha njëvjeçare**, që do t'ua bënin të mundur që të fillojnë së paguari këstet një vit pas marrjes së huasë. Ndër sugjerimet e tjera ishin që qeveria të mbulojë 50% të financimit për femrat e interesuara për të nisur një biznes, që bizneset e reja në pronësi të femrave që regjistrohen të jenë të liruar nga tatimi në qarkullim për dy apo tre vitet e para, dhe të krijohet një fond për subvencionimin e normave të larta të interesit për bizneset në pronësi të femrave, ashtu që ato të jenë në gjendje që t'i zhvillojnë bizneset edhe më tej.
- Pjesëmarrëset e grupeve të fokusit kanë thënë që janë përballur shpesh me perceptimin mbizotërues se bota e biznesit u përket meshkujve dhe femrat nuk kanë vend në të. Një pjesëmarrëse ka deklaruar që qiradhënësi i saj kishte rënë dakord për t'ia dhënë me qira një lokal për biznes, por që dy javë më pas kishte kërkuar ta takonte babanë e saj si garantues.
- Pjesëmarrëset kanë pohuar që, ndonëse janë të vetëdijshme për vështirësitë me të cilat përballen femrat ndërmarrëse, ato nuk janë ndjerë se femrat janë në disavantazh në biznes në kuptim të shkathhtësive. Është gjithashtu me rëndësi të përmendet që gjatë diskutimeve në grupet e fokusit, shumica e pjesëmarrëseve kanë pohuar që nuk ndjehen inferiore ndaj meshkujve dhe besojnë në aftësinë e tyre për të bërë biznes.<sup>51</sup>
- Derisa ka pasur ca shembuj të rasteve kur **gjatë regjistrimit të biznesit** femrave u është kërkuar që ta kenë të pranishëm edhe burrin apo babanë, shumica kanë deklaruar që nuk kanë pasur asnjë problem në këtë proces.

<sup>51</sup> Duke pasur parasysh se më se 41% të femrave të anketuara mendojnë se femrat nuk kanë prirje për biznes, pjesëmarrëset e grupeve të fokusit nuk janë mostër përfaqësuese e gjithë grave në Kosovë.

- Të gjitha pjesëmarrëset janë pajtuar rreth **mungesës së bashkëpunimit dhe krijimit të rrjeteve të kontaktit** mes femrave ndërmarrëse. Është theksuar nevoja për shkëmbim e përvojash dhe bashkëpunim. Gjatë diskutimeve në grupe të fokusit, organizatat sikurse Femrat në Biznes dhe G7 janë përmendur si burime të informacionit. Një pjesëmarrëse ka përmendur që do të themelojë një qendër biznesi për femra në Prishtinë.

#### 4.4. Mjedisi ligjor

Për qëllime të këtij raporti, mjedisi ligjor nënkupton si kuadrin ligjor, që mbron parimet e barazisë gjinore në Kosovë, ashtu edhe sistemin gjyqësor, detyrë e të cilit është që t'i mbështesë dhe zbatojë këto parime, pa anashkaluar paanshmërinë, efikasitetin dhe transparencën.

##### 4.4.1. Konteksti

Mjedisi ligjor i Kosovës vepron brenda një kuadri ligjor të ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore,<sup>52</sup> në pajtim me legjislacionin e BE-së për qëllim të integritetit në BE në të ardhmen. Akterë të panumërt e ndërtojnë makinerinë kombëtare për zbatimin dhe përforcimin e barazisë gjinore, duke përfshirë këtu ABGJ-në, Zyrën për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore (Zyra e Kryeministrit), Njësinë për Barazi Gjinore (Institucioni i Avokatit të Popullit), zyrtarët për barazi gjinore nëpër ministri dhe komuna, Grupin ndërministror për barazi gjinore, Komisionin e Kuvendit të Kosovës për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Grupin e femrave deputete dhe komitetet komunale për barazi gjinore.

Megjithatë, ç'është e drejta, ka mungesa në monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit ekzistues, gjë që kontribuon jo vetëm në dështimin për t'i përmbushur standardet e barazisë gjinore të BE-së por njëherësh i hap udhë edhe diskriminimit gjinor të mëtejshëm.

Vlerësimi gjinor i USAID-it në Kosovë në vitin 2012 i ka identifikuar disa çështje brenda kuadrit të sistemit ligjor të Kosovës që mund të kenë ndikim negativ te femrat: 1) mosefikasiteti i gjykatave në nxjerrje të vendimeve (posaçërisht në rastet e dhunës në familje dhe divorcit/kujdestarisë); 2) dështimi për të zbatuar ligjet lidhur me barazinë gjinore (për shembull, Ligji për barazi gjinore); 3) reputacioni i gjykatave si paragjykuese ndaj femrave ka çuar në shmangie të gjykatave dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve jashtë sistemit gjyqësor; dhe 4) fakti që gjyqtarët shpesh nuk e sqarojnë bazën e vendimeve të tyre (ndonëse ligji u kërkon që ta bëjnë këtë) do të thotë se femrave që humbasin pronën, fëmijët dhe pasuri të tjera nuk u jepet as edhe një sqarim për vendimin.<sup>53</sup>

Aspektet e të drejtave pronësore janë sfidë e veçantë për femrat. Projekti i USAID-it për ngritje të vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë, si dhe trembëdhjetë organizata të shoqërisë civile, kanë monitoruar gjykatat në Kosovë me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.<sup>54</sup> Aktivitetet e monitorimit janë përqendruar në disa çështje, duke përfshirë këtu trajtimin nga gjykatat të kontesteve pronësore që përfshijnë femra. Në këtë kuptim, nëpër gjykata janë vërejtur praktika diskriminuese të tilla si mosnjoftimi i bijave të martuara për procedurën trashëgimore (Gjykata Themelore në Gjakovë)<sup>55</sup> dhe këshillimi i femrave të martuara që pjesën e tyre të trashëgimisë t'ua japin vëllezërve (Gjykata Themelore në Pejë).<sup>56</sup> Ekzistimi i praktikave të tilla mund të kontribuojë në rritjen e ngurrimit të femrave për t'iu drejtuar

<sup>52</sup> Ligjet dhe politikat që mbrojnë barazinë gjinore në Kosovë përfshijnë: Kushtetutën e Kosovës (në vete përfshin KEDG-në), Ligji për barazi gjinore (aktualisht në rishikim e sipër?), Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, Ligjin kundër diskriminimit, Ligjin për familjen, si dhe Programin e Kosovës për barazi gjinore (2008-2013).

<sup>53</sup> Kethrin Kozarelli (2012), Vlerësim gjinor i vendit për USAID-in në Kosovë: Versioni për audiencë të jashtme, Uashington: USAID, f. 28.

<sup>54</sup> Shoqata e juristëve "NORMA" ka kryer një aktivitet tjetër të monitorimit të lëndëve të trashëgimisë. Për më shumë informata, shih Shoqata e Juristëve "NORMA", Hulumtimi dhe monitorimi i zbatimit të Ligjit për barazi gjinore.

<sup>55</sup> QTBA (2014), Gjetjet dhe rekomandimet e organizatave lokale nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave, Prishtinë: USAID-i në Kosovë, f. 7.

<sup>56</sup> QTBA (2014), Gjetjet dhe rekomandimet e organizatave lokale nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave, Prishtinë: USAID-i në Kosovë, f. 11.

sistemit gjyqësor për të kërkuar të drejtat e tyre pronësore. Në anketën e vitit 2011 rreth së drejtës pronësore trashëgimore të femrave, vetëm rreth 20 % e të anketuarve kanë qenë të mendimit se femrat kanë mbështetje të mjaftueshme nga sistemi i drejtësisë kur bëhet fjalë për realizimin e së drejtës trashëgimore.<sup>57</sup>

#### 4.4.2. Perceptimet që kanë dalë nga anketa

Pyetjet e anketës kanë mëtur që t'i masin mendimet e të anketuarve përkitazi me barazinë gjinore në kontekst të kuadrit ligjor, si dhe përvojat, besimin dhe njohuritë e tyre rreth sistemit gjyqësor të Kosovës.

Më pak se gjysma e femrave të anketuara mendojnë që meshkujt dhe femrat trajtohen në mënyrë të barabartë në Kosovë, ndërsa 39.83% janë të mendimit që, në të vërtetë, meshkujt trajtohen më mirë (shih Figurën 18).

Ç'është më interesante, pothuajse një e treta e meshkujve pranojnë se gëzojnë disa përparësi vetëm dhe vetëm sepse janë meshkuj, nga që edhe ata janë po ashtu të mendimit se trajtohen më mirë.




Figura 18 A trajtohen meshkujt dhe femrat ndryshe nga njëri-tjetri në shoqërinë tuaj? (të ndara sipas gjinisë) (B8)

Sipas hulumtimit, e drejta trashëgimore dhe pronësore janë një ndër fushat ku ndodh diskriminim i vazhdueshëm ndaj femrave. Gjetjet e anketës përkrijnë me realitetin, meqë më shumë se gjysma e të anketuarve (54.56%)<sup>58</sup> raportojnë që femrat në familjet e tyre nuk e ushtrojnë të drejtën e tyre në trashëgimi (shih Figurën 19). Në qoftë se përgjigjet zërthehen sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, rezulton që femrat serbe kanë më së shumti të ngjarë të kërkojnë të drejtën e tyre në trashëgimi (67.98%), krahasuar me përqindjen e raportuar prej 29.79% të atyre shqiptare.

<sup>57</sup> Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2011), E drejta e trashëgimisë pronësore të grave në Kosovë, Prishtinë, f.45.

<sup>58</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.




Figura 19 A e ushtrojnë femrat në familjen tuaj të ngushtë të drejtën e tyre në trashëgimi? (të ndara sipas gjinisë) (J1)

Më shumë se një e treta e të anketuarve të cilët kanë thënë se e drejta në trashëgimi ushtrohet nga femrat në familjen e tyre kanë përmendur zakonet familjare si arsye kryesore për këtë lloj sjelljeje (shih Tabelën 6).

	Meshkuj (%)	Femra (%)	Gjithsej (%)
Nuk e njohin ligjin	5.54	0.74	2.81
Tradita familjare	64.82	72.77	69.34
Nuk ka pronë për t'ua dhënë atyre	9.45	12.62	11.25
Ato vetë nuk duan të marrin trashëgimin	18.57	13.61	15.75
Të tjera	1.63	0.25	0.84

Tabela 6 Arsyet pse femrat nuk e ushtrojnë të drejtën në trashëgimi

Kur janë pyetur nëse kanë besim në sistemin gjyqësor, pak më shumë se një e treta e të anketuarve<sup>59</sup> kanë raportuar besim të plotë (shih Figurën 20). Të anketuarit që u besojnë deri-diku apo nuk u besojnë fare gjykatave kanë përmendur korrupsionin, padrejtësinë dhe mosefikasitetin si disa prej arsyeve kryesore që i shtyjnë të mendojnë në këtë mënyrë.




Figura 20 A keni besim te sistemi gjyqësor i Kosovës? (të ndara sipas gjinisë) (J3)

<sup>59</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.

Vetëm një e katërta deri një e treta e të anketuarve janë të mendimit se çështjet gjyqësore po zbatohen në mënyrë efektive (shih Figurën 21).




Figura 21 Sipas mendimit tuaj, a zbatohen çështjet gjyqësore në mënyrë efektive në Kosovë? (të ndara sipas gjinisë) (J4)

Gjithashtu, më se gjysma e të anketuarve (53.65%) mendojnë se femrat dhe meshkujt trajtohen njëjloj nga gjykatat,<sup>60</sup> me më shumë meshkuj (57.89%) sesa femra (50.29%) që e ndajnë këtë mendim (shih Figurën 22). Gjetje interesante është që një përqindje shumë e lartë e femrave të anketuara— 40.20% janë përgjigjur me nuk e di, ndoshta për shkak se nuk kanë pasur përvojë me sistemin gjyqësor. Kur u është kërkuar që të japin hollësi për atë se pse janë të mendimit që femrat nuk trajtohen njëjloj sikurse meshkujt, të anketuarit kanë dhënë përgjigje të ndryshme duke filluar nga “femrat nuk kanë pushtet”, “është më lehtë për meshkujt” deri “femrat nuk kanë të drejta”.




Figura 22 Sipas mendimit tuaj, a trajtohen femrat njëjloj sikurse meshkujt nëpër gjykata? (të ndara sipas gjinisë) (J5)

Kur janë pyetur për mosmarrëveshjet, të anketuarit kanë treguar mirëbesim më të madh te gjykatat kur bëhet fjalë për mosmarrëveshje personale, se ato që kanë të bëjnë me biznesin. Pothuajse 60% e të anketuarve<sup>61</sup> dinë se kujt duhet t’i drejtohen nëse kanë mosmarrëveshje personale (shih Figurën 23). Mirëpo, vetëm 41.63% e të anketuarve dinë si t’i trajtojnë mosmarrëveshjet.

<sup>60</sup> Rezultatet që kanë dalë nga mostra e gjithëmbarshme janë domethënëse në kuptimin statistikor. Mostra shqiptare ka prodhuar rezultate jodomethënëse në kuptimin statistikor.

<sup>61</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënëse në kuptimin statistikor.




Figura 23 A e dini se ku duhet të drejtoheni nëse keni ndonjë mosmarrëveshje personale? (të ndara sipas gjinisë) (J6)

Kjo duket të jetë sidomos problematike në rastin e femrave, sepse gati dy të tretat e femrave të anketuara nuk kanë ditur se çfarë duhet të bëjnë nëse kanë ndonjë mosmarrëveshje (shih Figurën 24).




Figura 24 A dini ku të drejtoheni në qoftë se keni ndonjë mosmarrëveshje në biznes apo në vendin e punës? (të ndara sipas gjinisë) (J7)

Tri të katërtat e të anketuarve (75.43%)<sup>62</sup> nuk kanë dëgjuar asnjëherë për ndërmjetësimin apo arbitrazhin si rrugë për zgjidhje të mosmarrëveshjeve (shih Figurën 25).




Figura 25 A keni dëgjuar për ndërmjetësimin apo arbitrazhin? (të ndara sipas gjinisë) (J8)

Për më tepër, madje edhe ata të anketuar të cilët e kanë ditur se çfarë është arbitrazhi, 71.49%<sup>63</sup> nuk e kanë ditur nëse ka të njëjtën peshë sikurse vendimi gjyqësor apo jo (shih Figurën 26).

<sup>62</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.

<sup>63</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.






Figura 26 A e ka ndërmjetësimi dhe arbitrazhi të njëjtën peshe sikurse vendimi gjyqësor? (të ndara sipas gjinisë) (J.8.1)

Përkundër nivelit të ulët të njohurive si të meshkujve ashtu edhe femrave për sa i përket çështjes së ndërmjetësimit dhe mosmarrëveshjeve në biznes/vend pune, 43.54%<sup>64</sup> e të anketuarve janë të mendimit se janë të informuar deri-diku për të drejtat e tyre si qytetarë të Kosovës, derisa 51.96% mendojnë se janë plotësisht të informuar (shih Figurën 27).




Figura 27 A mendoni që jeni të informuar për të drejtat tuaja si qytetar i Kosovës? (të ndara sipas gjinisë) (J.10)

#### 4.4.3. Përvoja me grupet e fokusit

Përgjithësisht, perceptimet dhe përvojat e pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit përfshijnë:

- Shumica e pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit kanë deklaruar që femrat në familjen e tyre e ushtrojnë të drejtën trashëgimore dhe pronësore. Megjithatë, shumë prej tyre gjithashtu kanë thënë që nuk do ta kërkojnë pjesën e tyre të trashëgimisë për arsye nga më të ndryshmet, që përfshijnë vëllezër e motra më pak të suksesshëm të cilëve janë më në nevojë, që s'kanë si të jenë më mirënjohëse ndaj prindërve për shkollimin që u kanë dhënë dhe nuk duan të kërkojnë tjetër gjë prej tyre. Në përgjithësi, arsyet për heqjen dorë të dikujt nga e drejta në pronë duket të jenë më tepër të bazuara në një kod moral të pranuar të drejtësisë e fajit, se sa në të drejtat e parapara me ligj. Gjithashtu, është përmendur se është e rëndësishme që brezat e rinj të edukohen për këtë çështje ashtu që, në të ardhmen, femrat të mos ketë më nevojë të luftojnë për të drejtën e tyre në pronë.
- Shumica e pjesëmarrëseve të grupeve të fokusit nuk kanë treguar besim në **efikasitetin dhe paanshmërinë e gjykatave**, dhe kanë deklaruar që parapëlqejnë që problemet e tyre në lidhje me biznesin t'i zgjidhin jashtë gjykatës. Për më tepër, shumë prej tyre kanë dhënë shembuj të përvojave personale me lëndëve gjyqësore që presin me vite të tëra derisa të zgjidhen.

<sup>64</sup> Dallimi i vrojtuar mes mendimeve të meshkujve dhe grave është jodomethënës në kuptimin statistikor.

- Ndonëse shumica e pjesëmarrëseve i shfrytëzojnë **kontratat me shkrim** dhe besojnë në dobinë e tyre, ato nuk presin ndonjë ndihmë nga sistemi juridik në rast se pala tjetër shkel kontratën. Andaj, ato parapëlqejnë që mosmarrëveshjet kontraktuale t'i zgjidhin jashtë gjykatës.

## 5. PËRFUNDIMET

Përkundër fokusit të kufizuar të këtij raporti, gjetjet tregojnë që perceptimet e barazisë gjinore në sektorin ekonomik dhe atë ligjor janë përgjithësisht më të larta se në realitet. Për shembull, derisa më se 80% e të anketuarve mund të duan që të besojnë se meshkujt dhe femrat kanë qasje të barabartë në marrjen e huave, të dhënat e siguruar nga po të njëjtit e thonë të kundërtën.

Gjithashtu, mund të argumentohet se vetë meshkujt dhe femrat e anketuara, si përfaqësues të gjithë shoqërisë kosovare, janë shpeshherë fajtorë për përjetësimin e pabarazisë gjinore - në bazë të besimeve stereotipike të shumta që i kanë në lidhje me rolet gjinore. Në dritën e aspiratave për t'iu bashkuar Bashkimit Evropian, është në interesin më të mirë të Kosovës që të punohet për t'i çrrënjësuar besimet e këtilla dhe që parimet e barazisë gjinore të promovohen në të gjitha sferat e jetës. Me këtë në mendje, një rezultat i dobishëm dhe praktik i këtij hulumtimi ka qenë identifikimi i pikënisjeve për rritjen e mundësive ekonomike dhe ligjore për femrat.

## 6. REKOMANDIME

Hulumtimi i Programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) siguron informata për disa veprime që, në qoftë se do të ndërmerreshin, mund të çojnë në fuqizimin e mëtejshëm të femrave dhe ndryshime pozitive në perceptimet ekzistuese të shtrembëruara të roleve gjinore. Çështjet gjinore janë shumështrësore dhe prekin shumë sektorë, dhe, si të tilla, kërkojnë vëmendje dhe veprim nga akterë dhe hisedarë të shumtë. Andaj, rekomandimet e këtij raporti për krijimin e mundësive më të mira ekonomike për femrat e Kosovës janë paraqitur duke u nisur nga konstatimi se bashkëpunimi midis donatorëve, qeverisë dhe shoqërisë civile është vendimtar për sukses dhe qëndrueshmëri.

### Rekomandimet në nivel shteti:

- **Të mblidhen dhe kategorizohen të dhëna sasore dhe cilësore në lidhje me pjesëmarrjen e femrave në ekonominë e Kosovës.** Siç është përmendur tjetërkund në këtë raport, ka nevojë të plotësohet mungesa e të dhënave të besueshme për numrin e bizneseve në pronësi të femrave, qëndrimin e këtyre ndërmarrjeve ndaj huamarrjes, hendekun gjinor në paga, numrin e femrave në ekonominë joformale etj. Ndonëse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka filluar të mbledhë të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë lidhur me pronësinë e NVM-ve, ende mbetet shumë për t'u bërë dhe nevojitet bashkëpunim mbarëqeveritar, duke përfshirë këtu Agjencinë e Statistikave, ABGJ-në, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe organizatat e tjera përkatëse, si dhe linja të qarta të llogaridhënies për mbledhjen, monitorimin dhe vlerësimin e të dhënave.
- **Të krijohen pako shërbimesh për femrat ndërmarrëse.** Bazuar në nevojat e femrave ndërmarrëse, Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve duhet të krijojë pako shërbimesh që, në varësi të rrethanave, mund të përfshijnë ndihmë financiare (deri në 50%) për hapje të biznesit të ri, lehtësira tatimore dhe qasje në shërbime për zhvillim të biznesit dhe këshillim.
- **Të fuqizohen dhe zgjerohen shërbimet që u ofrohen femrave të punësuara.** Shumica e femrave të anketuara kanë përmendur mungesën e ndihmës shtetërore si faktor kryesor për përfaqësimin e ulët të femrave në pozita të larta. ABGJ dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale duhet t'i identifikojnë nevojat e femrave të punësuara të cilat përpiqen t'i ngjitin shkallët e karrierës, si dhe të hartojnë një plan veprimi për ndihmë. Nismat specifike mund të përfshijnë trajnime teknike për grupe të synuara, rrjete të mentorimit dhe ndihmë në përkujdesjen për fëmijët. Gjithashtu, përkrahja e politikave të pushimit të lehonisë, që në vend të punëdhënësve do të mbronin dhe do të ishin në të mirë të femrave, është një hap i nevojshëm për të siguruar që sa më shumë femra të hyjnë dhe të qëndrojnë në tregun e punës.

- **Të bëhet identifikimi i bankave, IMF-ve dhe organizatave tjera që ofrojnë shërbime të huamarrjes për femrat ndërmarrëse.** Agjencia për Mbështetjen e NVM-ve duhet t'i ketë këto informata në dispozicion dhe t'i ndajë me klientët e vet.
- **Institucionet financiare në sektorin privat të inkurajohen për të siguruar kushte më të mira të huadhënies për femrat ndërmarrëse.** Në kuadër të përpjekjeve të veta për të rritur qasjen e bizneseve fillestare, dhe bizneseve në pronësi të femrave, në financa, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duhet t'i nxisë huadhënësit në sektorin privat që ta bëjnë të njëjtën, duke mbajtur parasysh shembujt e suksesshëm të ndërmarrjeve të ngjashme në vendet e tjera. Për shembull, në Turqi, pakoja e GarantiBank për mbështetjen e femrave ndërmarrëse (PMGN) ofron hua me afat pagese deri në 60 muaj dhe normë të veçantë interesi për NVM-të ekzistuese në pronësi të femrave që janë të interesuar të zgjerohen.<sup>65</sup> Nëse normat e ulëta të interesit nuk janë opsion, atëherë ofrimi i kushteve më të favorshme të huadhënies sikurse zvogëlimi i kërkesave për kolateral apo periudhë mospagimi (grejs periudhë) mund të jetë më i realizueshëm. Organizatat mikrokreditore sikurse MI - BOSPO ([www.mi-bospo.org](http://www.mi-bospo.org)) në Bosnje, që ofron periudha mospagimi deri në nëntë muaj, dhe "Mol Bulak Finance" në Kirgizstan ([www.mbf.kg](http://www.mbf.kg)), që ofron shërbime të huamarrjes në grup për femrat nga zonat rurale, janë shembuj tjerë të qasje kreative ndaj financimit.
- **Të nisen fushata avokimi për çështje të ndjeshme gjinore që përmbajnë shembuj të pabarazisë gjinore në ekonomi.** Siç tregojnë rezultatet e hulumtimit, popullsia e përgjithshme ka krijuar përshtypjen që barazia gjinore në Kosovë është më e madhe se në të vërtetë. Qeveria duhet t'i përdorë televizionet, radiostacionet, mediet sociale, afishet dhe gazetat si platformë për të shpërndarë informacione dhe njohuri. Për shembull, do të mund të fillohej një mori fushatash të llojit "A e dini se?" me statistika që tregojnë pozitën e pafavorshme të femrave (p.sh., "A e dini se vetëm 11 % e NVM-ve në Kosovë janë në pronësi të femrave?"). Krahasimet e tilla me meshkujt dhe statistikat nga vendet e tjera në Evropë, pa dalë jashtë kontekstit të kuadrit ligjor të Kosovës, kanë për qëllim që t'i nxisin njerëzit për të menduar "pse" ndodh kjo dhe çfarë rëndësie ka. Këto lloj përpjekje duhet të jenë sistematike, të kenë synime dhe objektiva të qarta, dhe të bëhen në bashkëpunim me donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile.

### Rekomandime për donatorët:

- **Të bëhet analiza gjinore e mjedisit që mundëson të bërit biznes.** Për t'i kuptuar plotësisht aspektet e ndryshme të mjedisit ligjor dhe ekonomik në të cilat veprojnë NVM-të, është me rëndësi që të bëhet një analizë gjinore e thuktë. Për qëllime të vlerësimit të mundësimit të bërit biznes, projekti BiZCLIR i USAID-it ka krijuar disa instrumente, duke përfshirë BiZCLIR, AgCLIR<sup>66</sup> dhe GenderCLIR. GenderCLIR ndihmon në identifikimin dhe analizën e sfidave ligjore dhe institucionale me të cilat përballen femrat ndërmarrëse në kuptim të kuadrit ligjor, institucioneve zbatuese, institucioneve mbështetëse dhe dinamikave sociale, duke përdorur këta tregues: zakonet shoqërore dhe roli i femrave në shoqëri; femrat dhe sektori privat; femrat dhe marrëdhënia e punës; femrat dhe huatë; femrat dhe pronësia; femrat dhe biznesa; dhe femrave dhe e drejta komerciale.<sup>67</sup> Ndonëse ky raport, si dhe raportet e tjera ekzistuese, tashmë i ofrojnë këto informata në një farë mase, duhet të bëhet një analizë e plotë e tërë mjedisit që mundëson të bërit biznes.
- **Të rritet vetëdija për ndërmjetësimin dhe arbitrazhin.** Siç është vërtetuar në këtë anketë, më pak se një e katërta e kosovarëve janë të vetëdijshëm për ndërmjetësimin dhe arbitrazhin si alternativë

<sup>65</sup> OBZHE (2012), Femrat në biznes: Politikat për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë së grave në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, Botim i OBZHE, f. 87.

<sup>66</sup> Vlerësimi AgCLIR i Kosovës nga ana e USAID-it është bërë në vitin 2010 dhe është në dispozicion në: [http://egateg.usaidallnet.gov/sites/default/files/Kosovo\\_Ag.pdf](http://egateg.usaidallnet.gov/sites/default/files/Kosovo_Ag.pdf)

<sup>67</sup> Shembulli i vlerësimit GenderCLIR të USAID-it për Ruandën mund të gjendet në: [http://egateg.usaid.gov/sites/default/files/Rëanda\\_GenderCLIR.pdf](http://egateg.usaid.gov/sites/default/files/Rëanda_GenderCLIR.pdf), ndërsa për Vietnamin është në dispozicion me kërkesë nga Programi për përmbardim dhe legjislacion komercial (CLE).

ndaj procedurave gjyqësore. Donatorët, shoqatat e biznesit dhe Qeveria e Kosovës duhet të punojnë më tej për ta informuar popullatën për këto shërbime.

- **Të vazhdohet bashkëpunimi me Dhomën Ekonomike të Femrave të Kosovës (G7).**

Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) i ka ndihmuar G7-tës në hartimin e planeve strategjike, planeve të aktiviteteve, si dhe buxheteve. Gjithashtu, G7 dhe CLE i kanë bashkuar forcat dhe kanë organizuar tryeza të rrumbullakëta për tema të tilla si përdorimi i kontratave në biznes dhe qasja në financa. Veç kësaj, Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) ka nisur të ofrojë trajnime të ngjashme për bizneset në pronësi të femrave ose organizatat dhe kompanitë e menaxhuara nga femrat. Teksa G7 vazhdon të rritet e të zhvillohet, Programi për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE) mund të vazhdojë që ta mbështetë me aktivitete tjera që, në afat të shkurtër, mund të përfshijnë analiza të vlerës zinxhimore për çështje gjinore të sektorëve që po shënojnë rritje të madhe në Kosovë, krijimin e një programi të këshillimit nga femrat me përvojë në ndërmarrësi për ndërmarrëset fillestare, si dhe ngritjen e rrjeteve të kontaktimit përmes internetit dhe përmes teknologjisë së telefonisë mobile (në këtë të fundit do të mund të kishin më shumë qasje femrat nga zonat rurale).

- **Të bëhet vlerësimi i nevojave të femrave ndërmarrëse për trajnime dhe të hartohet një plan veprimi mbi bazën e gjetjeve/rekomandimeve.**

Një studim i ndërmarrjeve në pronësi të femrave që është kryer në të gjitha vendet e Ballkanit ka gjetur që me interes të veçantë për femrat ndërmarrëse janë këto tema të trajnimit: organizimi dhe menaxhimi; financat dhe të kontabiliteti; zgjidhja e konflikteve dhe problemeve; dhe kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare për mjedisin e biznesit të NVM-ve.<sup>68</sup> Një raport i kohëve të fundit për zhvillimin ekonomik të femrave të komunitetit RAE ka dokumentuar një mungesë njohurish themelore të nevojshme për të nisur veprimtari që sjellin të ardhura, për shembull, aplikimin për hua.<sup>69</sup> Vlerësimi duhet të sigurojë që të merren parasysh nevojat specifike të grupeve të ndryshme të femrave.

- **Të krijohet dhe zbatohet një fond i veçantë garancish për femrat ndërmarrëse në kuadër të AKZH.**

Një burim i financimit për NVM-të në pronësi të femrave janë garancitë e përmes programit garantues të USAID-it me Autoritetin për Kredi Zhvillimore (AKZH), profemram ky që është dëshmuar më tërheqës në pjesë tjera të botës se sa në Kosovë. AKZH jep garanci të pjesshme të huave (zakonisht 50 %), për t'i inkurajuar huadhënësit privatë që t'i financojnë huamarrësit të cilët nuk shërbehen sa duhet.<sup>70</sup> Që nga viti 2008, AKZH ka dhënë hua për 18.1 %<sup>71</sup> të NVM-ve në pronësi të femrave në vendet në zhvillim, që përbëjnë 9.76 % të vlerës së portofolit të NVM-ve prej 523.2 milionë dollarë.<sup>72</sup> Deri tani, në Kosovë, ku garancitë e AKZH janë dhënë përmes Projektit të garancive për portofolin e huasë (GPH) në bashkëpunim me bankën Raiffeisen, për t'ju siguruar hua huamarrësve nga sektorët e bujqësisë dhe agrobiznesit, kanë qenë vetëm dy huamarrëse femra (nga gjithsej 4.76 % të huamarrësve) dhe 229 (pak më shumë se 25 %) bashkëhuamarrëse.<sup>73</sup> Në SBZHV-në e vet, USAID-i në Kosovë është zotuar që të zbatojë mekanizma për t'u dhënë hua femrave të cilat dëshirojnë të fillojnë ose rrisin një ndërmarrje.

<sup>68</sup> Qendra e Evropës Juglindore për mësimnxënie të ndërmarrësisë - SEECEL (2014), Analizë e nevojave për trajnim të grave ndërmarrëse: Qasje sistematike në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe Moldavi, Zagreb: SEECEL, f. 38.

<sup>69</sup> Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave dhe RROGRAEK (2013), Promovimi i fuqizimit ekonomik të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë, Prishtinë: UNËOMEN.

<sup>70</sup> Lara Storm (2013) Zhbllokimi i rritjes përmes garancive për kredi: Analizë e shkurtër e huave që u jepen NVM-ve në pronësi të grave, Uashington: USAID, f. 10.

<sup>71</sup> *Po aty*, f. 12.

<sup>72</sup> *Po aty*, f. 13.

<sup>73</sup> Weidemann Associates (2012), Vlerësim afatmesëm i performancës së Projektit të garancive për portofolin e huasë (GPH) të USAID-it në Kosovë me bankën Raiffeisen në Kosovë: Raport përfundimtar, Uashington: USAID, f. 21.

## Rekomandime për hisedarët përkatës:

- **Të organizohet një task-forcë a grup punues për të nisur dialogun për çështjet që kanë të bëjnë me femrat në biznes.** Përpjekjet aktuale për adresimin e fuqizimit ekonomik të femrave që po zbatohen nga qeveria, donatorët dhe organizatat e shoqërisë civile më tepër duket se po zhvillohen paralel njëra-tjetrës se sa bashkërisht. Femrat ndërmarrëse duhet të jenë të informuara për opsionet që i kanë në dispozicion në kuptim të krijimit të kontakteve në biznes, financimit, shërbimeve për zhvillim të biznesit, si dhe mbështetjeve tjera të nevojshme për fillim dhe zgjerim të bizneseve. Një grup i tillë pune do të përfshinte në radhët e tij ABGJ-në, UNDP-në, USAID-in, GIZ-in, Zyra për NVM-të pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, G7-shin, She-Era, Rrjetin e Femrave të Kosovës, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), dhe akterë tjerë përkatës, dhe do ta bënte të mundur shkëmbimin reciprok të ideve dhe hartimin e strategjive të sinkronizuara për rritjen e mundësive ekonomike të femrave në Kosovë.

## SHTOJCA 1: REFERENCAT

ABGJ (2014), Plani i veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 “Femrat, paqja dhe siguria” 2013-2015, Prishtinë: ABGJ.

Ana Stupnytska, Kethrin Kosh, Ejmi Mekbith, Sandra Lauson dhe Kejthi Katsui (2014), Të thurësh lëvdata të merituar: Si mund t’i japë shtysë rritjes globale zvogëlimi i hendekut kreditor për NVM-të në pronësi të femrave, Goldman Sachs.

QTBA (2014), Gjetjet dhe rekomandimet e organizatave lokale nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave, Prishtinë: USAID-i në Kosovë.

Checchi Consulting (2013), Analizë gjinore e Programit për përmbarim dhe legjislacion komercial (CLE), Uashington: USAID.

Deloitte Consulting sh.p.k. (2013), Sistemi i pikëreferimit në sektorin financiar: Pasqyrë për Kosovën, USAID.

BERZH (2013), Strategjia për Kosovën.

Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave dhe RROFEMRAEK (2013), Promovimi i fuqizimit ekonomik të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në Kosovë, Prishtinë: UNWOMEN.

IFC (2011), Fuqizimi i qasjes në financa për NVM-të në pronësi të femrave në vendet në zhvillim, Uashington: IFC.

Drejtesia dhe Qytetarët (2011) Anketë rreth opinionit publik në Kosovë, Prishtinë.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2011), E drejta e trashëgimisë pronësore të femrave në Kosovë, Prishtinë.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (2013), Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore në 2012 në Kosovë, Prishtinë: Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Oda Ekonomike e Kosovës dhe GIZ (2012), Pushteti aktual në vendimmarrje i femrave në Kosovë, qëndrimet dhe perspektivat në ekonomi, Prishtinë.

Agjencia e Kosovës për Mbështetjen e NVM-ve (2011), Strategjia e zhvillimit të NVM-ve për Kosovën 2012-2016, me vizionin 20/20, Prishtinë: Qeveria e Kosovës.

Lara Storm (2013), Zhblllokimi i rritjes përmes garancive për kredi: Analizë e shkurtër e huave që u jepen NVM-ve në pronësi të femrave, Uashington, DC: USAID.

Shoqata e juristëve “NORMA”, Hulumtimi dhe monitorimit i zbatimit të Ligjit për barazi gjinore, Prishtinë.

Federata e Punëdhënësve të Malit të Zi (FPM) (2013), Vlerësim i mjedisit për zhvillim të ndërmarrësisë nga femrat në Malin e Zi, Podgoricë: Federata e Punëdhënësve të Malit të Zi (FPM).

OBZHE(2012), Femrat në biznes: Politikat për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë së femrave në rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore, Botim i OBZHE.



Instituti Riinvest (2012), Sektori bankar: Lehtësues apo barrierë, Prishtinë: KFOS.

Instituti Riinvest (2013), Të paguash apo të mos paguash: Joformaliteti nga perspektiva e biznesit në Kosovë, Prishtinë: Instituti Riinvest.

Riinvest dhe CIPE (2012), Qeverisja korporative në ndërmarrjet publike në Kosovë: Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes së fondeve publike në Kosovë, Prishtinë: Instituti Riinvest.

Qendra e Evropës Juglindore për mësimnxënie të ndërmarrësisë - SEECEL (2014), Analizë e nevojave për trajnim të femrave ndërmarrëse: Qasje sistematike në Ballkanin Perëndimor, Turqi dhe Moldavi, Zagreb: SEECEL.

UNDP (2011), Përmirësimi i kënaqshmërisë publike me punën e gjyqësorit, Prishtinë: UNDP.

UNDP, Raporti i zhvillimit njerëzor të Kosovës 2012, Prishtinë: UNDP.

UNDP (2013), Raporti i pulsit publik VI, Prishtinë: UNDP.

USAID-i në Kosovë 2014-2018: Strategjia për bashkëpunim për zhvillimin e vendit, Prishtinë: USAID-i në Kosovë.

USAID-i në Kosovë, Profili i të drejtave pronësore dhe qeverisjes së burimeve.

Weidemann Associates (2012), Vlerësim afatmesëm i performancës së Projektit të garancive për portofolin e huasë (GPH) të USAID-it në Kosovë me bankën Raiffeisen: Raport përfundimtar, Uashington: USAID.

Women for Women International (2013), Mbyllja e hendekut: Ndikimi gjinor i sundimit të ligjit dhe zbatimit të tij në Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë: Raport përmbledhës, Londër: Women for Women International.

Banka Botërore, Njësia për zvogëlim të varfërisë dhe menaxhim ekonomik, rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore (2012), Kosova: Hendeqet gjinore në mundësitë arsimore, shëndetësore dhe ekonomike, Uashington: Banka Botërore.

## SHTOJCA 2: HOLLËSI PËR METODOLOGJINË

Anketa është dizajnuar për ta vlerësuar mendimin e tërë popullsisë së Kosovës. Në shërbim të këtij qëllimi, anketa ka përdorur një proces shumë-hapësh për përzgjedhjen e rëndomtë të të anketuarve për hulumtimin sasior. Ndërsa, për hulumtimin cilësor janë organizuar tri grupe të fokusit me femra ndërmarrëse.

### *Hulumtimi sasior*

Vendet e anketimit janë zgjedhur në mënyrë të rastësishme dhe janë përbërë 55.42 % nga zona urbane dhe 44,57 % nga zonat rurale. Në secilin vend janë përzgjedhur maksimalisht 10 të anketuar. Së pari, është përzgjedhur një shtëpi në afërsi të ndonjë ndërtese publike (shkollë, ndërtese qeveritare, xhami etj.) në qytetin/fshatin që ka qenë pjesë e anketimit. Pastaj, duke filluar nga shtëpia e parë, është zgjedhur çdo e pesta shtëpi e radhës. Brenda shtëpisë, të anketuarit janë përzgjedhur sipas metodës së rastit, në bazë të muajit të tyre të lindjes. Kështu, çdo pyetësor i dizajnuar përmbante një rubrikë për shënimin e muajit të lindjes, ku regjistruesit regjistronin datëlindjet e anëtarëve të familjes së përzgjedhur. Pas regjistrimit të datëlindjeve, anëtari i familjes me datën më të afërt të lindjes është përzgjedhur për të marrë pjesë në anketë. Kjo procedurë ka mundësuar zgjedhjen e rastësishme e të anketuarve, si dhe ka siguruar shumëllojshmëri të mostrës përfaqësuese. Kështu, nga gjithsej 38 komuna, me metodën e rastit janë zgjedhur 1.288 të anketuar të cilët përfaqësojnë përbërjen etnike të popullsisë së gjithëmbarshme të Kosovës. Derisa shumica e të anketuarve kanë qenë shqiptarë (64.30%), ashtu si është edhe shumica e popullsisë së Kosovës, në anketë kanë marrë pjesë edhe grupet tjera etnike: 17.81% serbë, 5.23% turq, 3.36% boshnjakë, 3.20% ashkalinj, 2.66% romë, 2.66% egjiptianë dhe 0.78% goranë. Për të siguruar kontroll të cilësisë, janë zbatuar protokolle rigoroze të mbikëqyrjes së punës në terren. Për të siguruar cilësinë e të dhënave, anketuesit kanë punuar nën mbikëqyrjen e personelit të FTK-së. Gjithashtu, anketuesit kanë vijuar trajnimet e nevojshme për t'i bërë dhe plotësuar anketat në mënyrë të mirëfilltë. Pas përfundimit të anketave, përmes telefonatave janë bërë verifikime të të dhënave. Tërë këto procedura kanë siguruar që përzgjedhja e mostrës dhe intervistat të bëhen pa gabime. Anketimi u bë në muajt nëntor dhe dhjetor 2013, dhe janar 2014.

### *Hulumtimi sasior*

Përveç anketës rreth mendimit të opinionit publik me anë të pyetësorëve, në janar të vitit 2014, u organizuar tri grupe të fokusit me qëllim hulumtimin e mëtejshëm të perceptimeve rreth femrave në biznes. Grupet e fokusit u ndanë në dy kategori: dy grupe fokusi me femra ndërmarrëse të martuara, si dhe një tjetër me femra ndërmarrëse beqare, të divorcuara dhe të veja. Gjithsej 40 femra ndërmarrëse morën pjesë në grupet e fokusit. Secili diskutim nëpër grupe të fokusit ka zgjatuar afërsisht prej një orë e dyzet minuta deri një orë e pesëdhjetë minuta.

Grupet e fokusit kanë diskutuar tema të ndryshme lidhur me femrat dhe biznesin, duke përfshirë: financat, krijimin e rrjeteve, regjistrimin e biznesit, gjykatat, të drejtat e femrave, si dhe perceptimet dhe sfidat karshi bizneseve me të cilat përballen femrat ndërmarrëse. Rezultatet e nxjerrura nga grupet e fokusit sigurojnë raste për studim të hendeqeve gjinore në ndërmarrësinë në Kosovë.

## SHTOJCA 3: ANKETA

### **PYETËSORI**

#### **Barazia gjinore në biznes**

Analizë e hulumtimit të opinionit publik

**Prishtinë, dhjetor 2013 – janar 2014**

## Informata menaxhuese

I-1. Nr i Pyetësorit. |\_\_|\_\_|\_\_|\_\_|

---

### I-2. Muaji i lindjes

- |           |            |            |             |
|-----------|------------|------------|-------------|
| 1. Janar  | 4. Prill   | 7. Korrik  | 10. Tetor   |
| 2. Shkurt | 5. Maj     | 8. Gusht   | 11. Nëntor  |
| 3. Mars   | 6. Qershor | 9. Shtator | 12. Dhjetor |

I-3. Data e intervistës: \_\_\_\_ \_\_\_\_

I-4. Regjioni \_\_\_\_\_ (shkruaj, PR, PZ, PE, MI, GJI, FR, GjA)

### I-5. BANIMI

Zonë rurale

Fshat

Qytet i vogël

Qendra Regjionale (Prizreni, Prishtina, Mitrovica, Peja, Ferizaji, Gjilani dhe Gjakova)

### I-6. Kodi i Qyteteve

- |               |              |                  |
|---------------|--------------|------------------|
| 1. Prishtina  | 11. Klinë    | 21. Ferizaj      |
| 2. Mitrovicë  | 12. Istog    | 22. Kaçanik      |
| 3. Gjilan     | 13. Deçan    | 23. Fushë Kosovë |
| 4. Pejë       | 14. Dragash  | 24. Obiliq       |
| 5. Prizren    | 15. Suharekë | 25. Novobërda    |
| 6. Gjakovë    | 16. Rahovec  | 26. Zubin Potok  |
| 7. Podujevë   | 17. Viti     | 27. Shtërpce     |
| 8. Vushtrri   | 18. Kamenicë | 28. Zvecan       |
| 9. Skenderaj  | 19. Lipjan   | 29. Glllogoc     |
| 10. Leposaviq | 20. Shtimë   | 30. Malisheve    |
| 31. Gracanice |              |                  |

I-7. Kodi i Intervistuesit: \_\_\_\_ \_\_\_\_ \_\_\_\_

### I-8. Intervista është përfunduar gjatë ...

1. vizitës së parë në shtëpi?
2. vizitës së dytë (kthyes) në shtëpi?
3. vizitës së tretë në shtëpi?

I-9. Regjistro Kohën (duke përdorur sistemin 24 orësh) : \_\_\_\_ : \_\_\_\_

**I-10. Regjistro Kohëzgjatjen e Intervistës në minuta:** \_\_\_\_ \_\_\_\_ (Regjistro kohën më të gjatë se 99 minuta si 99)

**Filloni Këtu Procedurat e Mostrifikimit**

1. Pasi keni zgjedhur një shtëpi ose apartament duke përdorur teknikën e rastit rrugë,
2. Prezantohu: "Mirëmëngjesi/mirëdita/mirëmbrema. Unë jam \_\_\_\_\_".

Unë jam duke punuar për organizatën FTK. Ne po kryejmë një hulumtim të opinionit publik në tërë Kosovën dhe duam të intervistojmë një person nga familja juaj. Ne do të zgjedhim këtë person në mënyrë të rastësishme, varësisht se kush nga familja juaj e ka ditëlindjen më të afërt. FTK është duke zhvilluar këtë sondazh të opinionit në mënyrë që të kuptojmë perceptimet e qytetarëve për çështjet sociale në Kosovë. Për këtë qëllim, ju jeni zgjedhur rastësisht një prej 1.300 të anketuarve, si numrat në një lojë lotarie, në mënyrë që të krijohet mostra reprezentative për popullatën e Kosovës. Emri juaj nuk do të regjistrohet në bazën e të dhënave, në këtë mënyrë mendimi juaj do të jetë konfidencial dhe anonim. Përgjigjet tuaja nuk do të komunikohen me ndonjë person tjetër, por do të përpilohet një bazë e të dhënave vetëm për qëllime statistikore. Përgjigjet në këtë intervistë do të jenë rreptësisht konfidenciale, sipas standardeve ndërkombëtare kërkimore".

**I-11.** Pyet për inicialet e emrave, gjininë dhe moshën e të gjithë anëtarëve të familjes të cilët janë 18 vjeç ose më të vjetër. Kur të kompletohet lista, pyet për ditëlindjet e secilit person.

Numri	Inicialet e emrit	Gjinia	Mosha	Ditëlindja
1.	_____	_____	_____	_____
2.	_____	_____	_____	_____
3.	_____	_____	_____	_____
4.	_____	_____	_____	_____
5.	_____	_____	_____	_____
6.	_____	_____	_____	_____
7.	_____	_____	_____	_____
8.	_____	_____	_____	_____
9.	_____	_____	_____	_____
10.	_____	_____	_____	_____
11.	_____	_____	_____	_____
12.	_____	_____	_____	_____
13.	_____	_____	_____	_____
14.	_____	_____	_____	_____
15.	_____	_____	_____	_____

4. Personi me ditëlindjen e ardhshme (duke shikuar ditëlindjen më të afërt në të ardhmen) është respodenti i përcaktuar për atë familje. Tani përpikuni që të kryeni intervistën me respodentin e përcaktuar.
5. Nëse respodenti i përcaktuar është në shtëpi dhe refuzon intervistimin apo ndonjë anëtar i familjes e bllokon intervistën, me mirësjellje largohuni nga shtëpia dhe shkoni në shtëpinë ose apartamentin tjetër të përshtatshëm në atë rrugë.
6. Nëse respodenti i përcaktuar nuk është në shtëpi, bëjeni të pamundurën të caktoni një intervistë për më vonë atë ditë (në zonat rurale), ose në çdo kohë tjetër në periudhën e punës në terren (në zonat urbane).  
Regjistro datën dhe kohën e terminit të caktuar : Data: \_\_\_\_\_ Koha: \_\_\_\_\_

**B-1. Gjatë 12 muajve të fundit, a keni marrë pjesë në ndonjë nga aktivitetet e mëposhtme (Përgjigje e shumëfishhtë)**

Keni implementuar projekte në OJQ?	1
Keni qenë përfitues i projekti në ndonjë OJQ?	2
Keni implemntuar projekte të qeverisjes lokale?	3
Keni qenë përfitues i ndonjë projekti të qeverisjes lokale?	4
Keni marrë pjesë në veprimtari sindikale?	5
Keni marrë pjesë në debate publike?	6
Keni marrë pjesë ne protesta publike?	7
Keni marrë pjesë në aktivitete të ndonjë partie politike?	8
Keni marrë pjesë në aktivitete të sektorit privat?	9

**B-2. Sa i kënaqur jeni me...**

Sa i kënaqur jeni me...	Shumë i/e kënaqur	Disi i/e kënaqur	Disi i/e pakënaqur	Shumë i/e pakënaqur	Nuk e di
B-2.1 Jetën tuaj private	5	4	3	2	1
B-2.2 Me punësimin tuaj të tanishëm	5	4	3	2	1
B-2.3 Me situatën ekonomike të familjes suaj	5	4	3	2	1
B-2.4 Me situatën ekonomike në Kosovë	5	4	3	2	1

**B-3. Sipas mendimit tuaj çfarë është e rëndësishme për punësim në sektorin privat?**

1. Përvoja profesionale
2. Edukimi
3. Trajnimet profesionale
4. Ryshfeti
5. Lidhjet familjare
6. Miqtë
7. Gjinia
1. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-4. Sipas opinionit tuaj kush është udhëheqës më i mirë në biznes?**

1. Burrat
2. Gratë
3. Të dy gjinitë
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-4.1 (Nëse përgjigja 1 apo 2, parashtro pyetjen Pse?)**

Pse? \_\_\_\_\_

**B-5. Sipas mendimit tuaj çfarë është e rëndësishme për punësim në sektorin publik?**

1. Përvoja profesionale
2. Edukimi
3. Trajnimet profesionale
4. Ryshfeti
5. Lidhjet familjare
6. Miqtë
7. Gjinia
8. Nuk e di
9. Ref/PP

**B-6. Sipas opinionit tuaj, kush është lider më i mirë në politik?**

1. Burrat
2. Gratë
3. Të dy gjinitë njëjtë

**B-6.1 (Nëse përgjigja e respondentit është 1 apo 2 në B-6, pyet Pse?)**

Pse? \_\_\_\_\_

**B-7. A do të ndiheshit rehat të punonit nën mbikëqyrjen e një shefeje ose drejtori femër?**

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di
4. Ref/PP

**B-7.1 (Nëse përgjigja e responentit është 1 apo 2 në B-7, pyet Pse?)**

Pse? \_\_\_\_\_

**B-8. A trajtohen ndryshe burrat dhe gratë në shoqërinë tuaj?**

1. Të dy gjinitë trajtohen në mënyrë të barabartë
2. Jo, në përgjithësi burrat janë të favorizuar
3. Jo, në përgjithësi gratë janë të favorizuara
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-9. Nëse të dy palët (burrat dhe gratë) e kanë moshën dhe nivelin e shkollimit të njëjtë, cili prej tyre do të ketë mundësi më të mëdha për t'u punësuar?**

1. Burrat
2. Gratë
3. Që dy kanë të njëjtat mundësi
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-9.1 (Nëse përgjigja e responentit është 1 apo 2 në B-9, pyet Pse?)**

Pse? \_\_\_\_\_

**B-10. Nëse të dy palët (burrat dhe gratë) kanë moshë dhe shkollim të njëjtë, dhe janë të punësuar, cili prej tyre ka më shumë gjasa që ta humb punën?**

1. Burrat
2. Gratë
3. Mundësitë janë të barabarta
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-10.1 (Nëse përgjigja e responentit është 1 apo 2 në B-10, pyet Pse?)**

Pse? \_\_\_\_\_



**B-11. A mendoni se burrat dhe gratë konsiderohen intelektualisht dhe fizikisht të barabartë në shoqëri?**

1. Po, ata konsiderohen intelektualisht dhe fizikisht të barabartë
2. Ata konsiderohen vetëm fizikisht të barabartë
3. Ata konsiderohen vetëm intelektualisht të barabartë
4. Jo, ata nuk konsiderohen të barabartë as intelektualisht as fizikisht
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**B-12. Kush është më i mirë në profesionet e mëposhtme Burrat, Gratë apo të dy gjinitë njëjtë?**

	Burrat	Gratë	Të dy njëjloj	Nuk e di
B-12.1 Profesor ne Fakultet	1	2	3	88
B-12.2 Infermier	1	2	3	88
B-12.3 Taksist	1	2	3	88
B-12.4 Drejtor Marketingu	1	2	3	88
B-12.5 Konsultant biznesi	1	2	3	88
B-12.6 Ekonomist	1	2	3	88
B-12.7 Gjykatës	1	2	3	88
B-12.8 Menaxher	1	2	3	88
B-12.9 Anëtar parlamentit (deputet)	1	2	3	88
B-12.10 Drejtor banke ose organizatave të mëdha	1	2	3	88
B-12.11 Kryetar komune	1	2	3	88
B-12.12 Kirurg/ Mjek	1	2	3	88
B-12.13 Staf të Teknologjisë Informative IT	1	2	3	88
B-12.14 Fermer/Bujk	1	2	3	88
B-12.15 Politikan	1	2	3	88
B-12.16 Gazetar	1	2	3	88
B-12.17 Pastrues	1	2	3	88
B-12.18 Roje sigurie	1	2	3	88

**B-13. A mendoni a ka me shume femra apo meshkuj ne biznes?**

1. Femra
2. Meshkuj
3. Njëjtë
4. Nuk di

(Nëse përgjigja 2, Burrat ne B-13 parashtro pyetjen )

### B-13.1 Pse ka më pak femra në biznes në Kosovë?

	Arsye e madhe	Arsye e vogël	Asnjë arsye	Nuk e di
B-13.1.1 Gratë përballin diskriminim në të gjitha fushat; biznesi nuk është përjashtim	1	2	3	88
B-13.1.2 Përgjegjësitë familjare të grave nuk u lejnë kohë për biznes	1	2	3	88
B-13.1.3 Më pak gra kanë eksperiencë në biznes	1	2	3	88
B-13.1.4 Gratë nuk kanë kapital për biznes	1	2	3	88
B-13.1.5 Gratë nuk kanë prirje për biznes	1	2	3	88
B-13.1.6 Gratë nuk kanë ambicije për biznes	1	2	3	88
B-13.1.7 Gratë nuk ndihen të sigurt në biznes	1	2	3	88

### B-14. Në rrethin tuaj, kush ka më shumë gjasa të ketë pozitë më të lartë në një kompani?

1. Femrat
2. Meshkujt
3. Njëjtë
4. Nuk di

### B-15. Pse gratë nuk arrijnë pozita aq të larta sa burrat gjatë karrierës së tyre?

	Po	Jo	Nuk e di
B-15.1 Nuk i kanë atributet/shkollimin/aftësitë	1	2	88
B-15.2 Nuk mund të jenë po aq të përkushtuara sa burrat për punë të paguar	1	2	88
B-15.3 Për shkak të zgjedhjes personale	1	2	88
B-15.4 Për shkak të presionit nga familja	1	2	88
B-15.5 Presion nga kolegët në rrethin e ngushtë profesional	1	2	88
B-15.6 Mungesë të ndihmës nga shteti	1	2	88
B-15.7 Sektori i biznesit është i dominuar nga burrat	1	2	88
B-15.8 Tradita kosovare nuk i inkurajon ato mjaftueshëm	1	2	88
B-15.9 Nuk ka mjaftueshëm qendra për kujdes ditorë për fëmijët	1	2	88

**B-16. A jeni pronarë/e të biznesit privat?**

1. Po,
2. Jo
3. Familja ime ka biznes
99. Ref/PP

(Nëse përgjigja ne B-16. PO atëherë vazhdo me këtë pyetje B-16.1; Nëse Jo vazhdo te B-16.2)

**B-16.1. Nëse jeni pronarë/e të biznesit privat, kush merret me punët e përditshme?**

1. Unë personalisht
2. Bashkëshorti
3. Fëmijët
4. Një familjar tjetër
3. Punëtori/ja

**B-16.2. A jeni kyqur në ndonjë aktivitet që gjeneron të ardhura (nuk do të thotë domosdoshmërisht që biznesi të jetë i regjistruar)**

1. Po,
2. Jo (nëse përgjigja është jo atëherë vazhdo me pyetjen B-22)
3. Familja ime ka biznes
99. Ref/PP

**B-17. A ka familja e juaj biznes privat?**

1. Po,
2. Jo
99. Ref/PP

(Nëse respodenti përgjigjet nën 1 Po në B-17, pyete në emër të kujt është regjistruar biznesi?)

**B-17.1 Në emër të kujt është regjistruar**

**biznesi?** \_\_\_\_\_

**B-18. Nëse familja juaj ka biznes, a merrni pjesë në mënyrë aktive në biznes**

1. Po shume
2. Po ndonjëherë
3. Pak
4. Aspak
5. Pa përgjigje

**B-19 . Nëse jeni aktiv, cilat janë detyrat tuaja kryesore?**

1. Vendim-marrje
2. Detyrat operative të përditshme
3. Detyra e përditshme fizike
4. Pa përgjigje

**B-20. Nëse keni biznes ju apo familja, si e keni filluar biznesin? (mund të jenë më shumë përgjigje)**

1. me kapitalin personal
2. me kapital të familjes
3. me kredi nga banka
4. me hua nga një i afërm
5. me donacion nga organizatat ndërkombëtare
6. me donacion nga organizatat vendore

**B-21. Nëse posedoni biznes, cilat janë problemet kryesore me të cilat ballafaqoheni?**

	<b>Problem i madh</b>	<b>Deri diku</b>	<b>Aspak</b>
B-21.1 Niveli i taksave	3	2	1
B-21.2 Procesi i pagesës	3	2	1
B-21.3 Sistemi ligjor	3	2	1
B-21.4 Mungesa e kapitalit për investim	3	2	1
B-21.5 Normat e larta e kamatave	3	2	1
B-21.6 Aftësitë e ulëta të punonjësve	3	2	1
B-21.7 Korrupsioni	3	2	1
B-21.8 Të tjera	3	2	1

**B-22. A kanë burrat dhe gratë qasje të barabarte në biznes?**

1. Po, të dy gjinitë kanë qasje të barabartë
2. Jo, në përgjithësi burrat janë më të favorizuar
3. Jo, në përgjithësi gratë janë më të favorizuara
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**(Nese përgjigja e respondentit ne B-22 eshte 2 ose 3, parashtro pyetjen ne vijim)**

**B-22.1 Pse nuk kane qasje te barabarte?**

1. Për shkak të edukimit
2. Për shkak të traditës
3. Për shkak të mungesës së njohjes së legjislacionit
4. Për shkak të mungesës së financave
5. Për shkak të dallimeve gjinore p.sh. amësia
6. Për shkak të mungesës së qendrave për kujdes ditor për femijet?
7. Të tjera \_\_\_\_\_

**B-23. A kanë burrat dhe gratë qasje të barabarte në “mbështetje për themelimin e biznesit”?**

1. Po, të dy gjinitë kanë qasje të barabartë në këto shërbime
2. Jo, në përgjithësi burrat janë më të favorizuar
3. Jo, në përgjithësi gratë janë më të favorizuara
88. Nuk e di
99. Ref/PP

(Nese përgjigja e respondentit ne B-23 eshte 2 ose 3, parashtro pyetjen ne vijim B-23.1)

**B-23.1. Pse nuk kane qasje te barabarte për mbështetje?**

1. Për shkak të edukimit
2. Për shkak të traditës
3. Për shkak të mungesës së njohjes së legjislacionit
4. Për shkak të mungesës së financave
5. Për shkak të mungesës së informacionit
6. Të tjera \_\_\_\_\_

**B-24. A posedoni ju personalisht një të një nga asetet e mëposhtmet? (Zgjedhja e shumëfishtë është e mundur)**

1. Shtëpi
2. Banesë
3. Shitore
4. Tokë
5. Veturë
6. Laptop
7. Telefon mobil
99. Ref/PP

**B-25. Nëse zotëroni pronë, a e keni blerë vet apo e keni trashëguar?**

1. E kamë blerë vet
2. E kamë trashëguar
3. Të dyja

**B-25.1 Nese ka toke (pyetja 24, edhe 4 Toke) atehere sa toke posedoni?**

1. Më pak se 0.5 ha
2. Mes 0.5 dhe 1 ha
3. Mes 1 dhe 2 ha
4. Mes 2 dhe 3 ha
5. Mes 3 dhe 4 ha
6. Më shumë se 4 ha
7. Nuk posedon
88. Nuk e di
99. Refuzon

**B-26. A keni marre ndonjëherë hua nga banka apo institucione tjera financiare (mikrofinanca, kredi per konsumator)?**

1. Po
2. Jo
99. Ref/PP

**B-27. A e dini se çka është institucioni mikro financiar**

1. Po
2. Jo
99. Ref/PP

**B-28. A e njihni ju personalisht ndonjë grua qe ka marr hua nga ndonjë institucion financiar?**

1. Po
2. Jo
99. Ref/PP

**B-29. A mendoni se gratë e kanë më të lehtë të marrin kredi se sa burrat?**

1. Më të lehtë
2. Më vështirë
3. Njëjtë
99. Ref/PP

**I-1. A keni ju personalisht:**

	Po	Jo
I-1.1 Telefon mobil	1	2
I-1.2 Kompjuter ose laptop	1	2
I-1.3 Llogari bankare	1	2
I-1.4 Kredit kartel	1	2

**I-2. A keni marre pjese ne ndonjëherë nga aktivitete e poshtëshënuara:**

	Po	Jo
I-2.1 Trajnime profesionale	1	2
I-2.2 Trajnime të organizuara nga OJQ	1	2
I-2.3 Trajnime të organizuara nga universiteti	1	2
I-2.4 Trajnime të organizuara nga sektori privat	1	2

**J-1. A praktikohet e drejta e trashëgimisë së pronës për femrat në familjen tuaj të ngushtë?**

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di

**J-2 Nëse jo pse?**

1. Nuk kanë informacion për ligjin
2. Tradita familjare
3. Nuk ka pronë për tu ndarë
4. Ato vetë nuk donë të janë trashëgimtare.
5. Tjetër

**J-3. A i besoni sistemit gjyqësorë në Kosovë?.....**

1. Po, plotësisht
2. Deri diku
3. Jo

**(Nëse përgjigja e respondentit ne J-3 është 2 ose 3, parashtro nen-pyetjen vijuese J-3.1)**

**J-3.1. Nëse deri diku apo jo, perse nuk i besoni sistemit gjyqësor?**

---

**J-4. A mendoni se çështjet ligjore zbatohen ne mënyre efektive ne Kosove?**

1. Po
2. Jo
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**J-5. A mendoni se gratë kane trajtim te barabarte si burrat ne Kosove?**

1. Po
2. Jo
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**J-5.1 Nëse jo perse?\_\_\_\_\_**

**J-6 Nëse keni ndonjë mosmarrëveshje personale a dini se ku duhet te drejtoheni?**

1. Po
2. Jo

**J-6.1. Nëse po, ku?\_\_\_\_\_**

**J-7 Nëse keni ndonjë mosmarrëveshje në biznes apo punë, a dini se ku duhet te drejtoheni?**

1. Po
2. Jo

**J-7.1 Nëse po ku \_\_\_\_\_**

**J-8. A keni dëgjuar për metodat alternative për zgjedhjen e kontesteve (ndërmjetësimin dhe arbitrazhin)?**

1. Po
2. Jo

**(Nëse përgjigja e respondentit në J-8 është 1, parashtro nen-pyetjen vijuese J-8.1)**

**J-8.1 A e dini që vendimet e ndërmjetësimit dhe arbitrazhit kanë të njëjtën fuqi sikur gjykata?**

1. Po , kanë të njëjtën fuqi
2. Nuk kanë të njëjtën fuqi
3. Nuk e di
4. Ref/PP

**J-9. Në përgjithësi, sa i/e sigurt ndiheni prej dhunës dhe krimit kur jeni në rrugë?**

1. Shumë sigurt
2. Pjesërisht i sigurt
3. Pjesërisht i pasigurt
4. Shumë i pasigurt
88. Nuk e di
99. Ref/PP

**J-10 . A i dini të drejtat e juaja si qytetar të Kosovës?**

1. Po
2. Deri diku
3. Jo
99. Ref/PP

**J-11. A mendoni që gjyqësia në Kosovë mund t'i mbrojë të drejtat tuaja?**

1. Po, plotësisht
2. Deri diku
3. Jo
99. Ref/PP



**Demografia:**

**D1. GJINIA:**

1. Mashkull
2. Femër

**D2. MOSHA:**

(Vitet) Shkruaje moshën | \_\_\_ | \_\_\_ |

**D3. (STATUSI MARTESOR): Aktualisht jeni:**

1. I/e martuar
2. I/e pamartuar
3. I/e divorcuar
4. I/e ve
5. Bashkëjetesë
99. Ref/PP

**D4. (EDUKIMI) A mund të më tregoni se cili është niveli arsimor më i lartë i arritur:**

1. Pashkollë/ analfabet
2. Pashkollë / por di shkrim lexim
3. Shkolla fillore e papërfunduar
4. Shkolla fillore
5. Shkolla e mesme
6. Shkolla e mesme e papërfunduar
7. Jam duke ndjekur shkollën teknike /profesionale
8. Jam duke ndjekur universitetin
9. Universiteti ose më lartë
99. Ref/PP

**D4.1 Arsyet për të mos ndjekur shkollimin (nëse 1,2,3,4,6 në D4):**

1. Arsyet ekonomike
2. Martesa
3. Shkollimi nuk është i rëndësishëm
4. Problemet shëndetësore
5. Të tjera (specifikoni) : \_\_\_\_\_
99. Ref/PP

**D5. (ETNIA): Cila eshte etnia (nacionaliteti) juaj/cilit grup etnik i takoni?**

1. Shqiptar
2. Serb
3. Boshnjak
4. Goran
5. Turk
6. Rom
7. Ashkali
8. Egjiptian
99. Tjetër: \_\_\_\_\_

**D-6. Cilat nga mjetet e poshtëshënuara i keni këtu në shtëpinë tuaj që funksionojnë në rregull?**

	Po	Jo
D-6.1 Kompjuter	1	2
D-6.2 Internet	1	2
D-6.3 Telefon mobil	1	2
D-6.4 Telefon fiks	1	2
D-6.5 Veturë	1	2
D-6.6 Traktor	1	2
D-6.7 Gjenerator në shtëpi	1	2

**D-7 A posedon familja juaj ndonjë të asetat e mëposhtme? (përgjigja e shumëfishtë mund të aplikohet)**

1. Shtëpi
2. Banese
3. Dyqan
4. Toke
5. Shtëpi pushimi (vikendice)
6. Ref/PP

**D-8. A keni në këtë vendbanim...**

	Po	Jo
D-8.1 Furnizimi me ujë të pijshëm	1	2
D-8.2 Kanalizimi / në sistemit publik	1	2
D-8.3 Ngrohje qendrore	1	2
D-8.4 Energji elektrike	1	2
D-8.5 Shërbim të mbledhjes së berllogut	1	2

**D-9. Personi qe është përgjegjës te paguaj faturat komunale (p.sh. personi ne emër te se cilit janë llogarite e faturave a është femër apo mashkull?**

1. Meshkujt
2. Femrat
3. Disa fatura paguhen nga burri disa nga gruaja
4. Ref/PP

**D-10. A jeni ju...**

1. duke punuar?
2. shtëpiake?
3. student apo praktikant?
4. i pensionuar?
5. me aftësi të kufizuara?
6. I/e papunë por duke kërkuar punë?
7. I/e papunë por nuk jeni duke kërkuar punë?
8. Nuk e di

**D-11. (Filtër. Pyeti vetëm ata që "duke punuar") A jeni tani të punësuar me orar të plotë ose me orar të pjesshëm?**

1. Me orar të plotë
2. Me orar të pjesshëm

**D-12. Kush është kryefamiljari i kësaj familje?**

1. Respondenti
2. Ndonjë person tjetër

**D-13. (Pyet vetëm ata që janë përgjigjur “duke punuar” në D-10): Cila është puna juaj, çfarë pune jeni duke bërë tani, madje edhe në qoftë se nuk është puna që ju jeni të kualifikuar profesionalisht? (Anketuesit: Pë rata që janë përgjigjur i/e papunë apo në pension / me aftësi të kufizuara, pyesni respondentin se cili ka qenë profesioni i tyre i fundit kur kanë punuar. Rretho më poshtë).**

**D-14. Cili është profesioni juaj apo ai i kryefamiljarit?**

	D-12.a. Profesioni i respondentit	D.12.b. Profesioni i kryefamiljarit
D-14.1 Pronar i biznesit të vet	1	1
D-14.2 Menaxher i ndërmarrjes	2	2
D-14.3 Menaxher i divizionit apo departamentit	3	3
D-14.4 Profesionist	4	4
D-14.5 Nëpunës	5	5
D-14.6 Niveli punonjës zyre	6	6
D-14.7 Teknik	7	7

D-14.8 Punëtor i kualifikuar	8	8
D-14.9 Semi-punëtor i kualifikuar	9	9
D-14.10 Punëtor i pakualifikuar	10	10
D-14.11 Ushtarak	11	11
D-14.12 Nëpunësit civil (policia, mësuesit, etj.)	12	12
D-14.13 Fermer, peshkatar	13	13
D-14.14 Punëtor pa tokë bujqësore	14	14
D-14.15 Tjetër (Specifiko):	15	15
D-14.16 Nuk është pyetur/Ska punuar ndonjëherë/Kalo	16	16
D-14.17 Nuk e di/Refuzon	17	17

**D-15. Sa anëtar i ka familja juaj (që jetojnë në Kosovë)? \_\_\_\_\_**

**D-16. Sa anëtar nga familja juaj janë nën moshën 15 vjeç? \_\_\_\_\_**

**D-17. Nëse keni fëmijë nën moshën 7 vjeç, kush kujdeset për ta gjatë ditës?**

1. Çerdhe/Qendra ditore
2. Nëna e tyre
3. Gjyshërit
4. Anëtar tjerë të familjes
5. Tjetër \_\_\_\_\_

**D-18. A mund të na tregoni shumën totale të shpenzimeve mujore në familjen tuaj?**

Shkruaj \_\_\_\_\_ Euro

**D-18.1 A mund të tregoni totalin e të ardhurave të familjes suaj, duke përfshirë të ardhurat e marra ose fituara nga të gjithë anëtarët e familjes me të cilët jetoni?**

Shkruaj \_\_\_\_\_ Euro

**D-19. (BANIMI) Cili është statusi juaj i banimit?**

1. Shtëpi/banesë private
2. Shtëpi/banesë me qira
3. Shtëpi/banesë pa pagesë (pa qira)
4. Banimi i përkohshëm
99. Ref/PP

**EMRI I ANKETUESIT** \_\_\_\_\_

**DATA E INTERVISTËS** \_\_\_\_\_

**Shënimet e Anketuesit:**

**Sinqeriteti i respondentit** (i ultë) 1 2 3 4 5 (i lartë)

**Bashkëpunimi i respondentit** (i ultë) 1 2 3 4 5 (i lartë)